



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 173 Akti

Nr. 217 Vendimi
Tiranë, më 05.12. 2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare znj. Mia Roessing, në datat 2.12.2019 dhe 5.12.2019, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Doreza H. Musabelliu**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatimin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Doreza Musabelliu, proces i cili ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tre kritereve: të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, dhe në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Doloreza Musabelliu është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë e pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016”), të gjithë prokurorët, i nënshtrohen rivlerësimit, *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, ushtron funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, që prej vitit 2005 dhe aktualisht.
3. Me shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 3.9.2018, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu.
4. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me nr. *** prot., datë 5.4.2019, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës të deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH nr. ***, datë 2.4.2019. Me shkresën nr. ***prot, datë 11.9.2019, DSIK-ja ka vënë në dispozicion raportin e deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH nr. ***, datë 11.9.2019.
5. Me shkresën nr. 351 prot., datë 19.4.2019, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me nr. 3037 prot., datë 19.4.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP) ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu.
6. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka zhvilluar shortin në datën 17.9.2018 nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Firdes Shuli.
7. Trupi gjykues, me fillimin e procesit të rivlerësimit, administroi:
 - 7.1 Aktin për vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga ILDKPKI-ja;
 - 7.2 Raportin e vlerësimit të figurës, sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016, nga DSIK-ja;
 - 7.3 Raportin e vlerësimit profesional, sipas neneve 40 – 44, të ligjit nr. 84/2016, nga KLP-ja.
8. Me vendimin nr. 1, datë 3.10.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Doloreza Musabelliu, duke përfshirë të tria kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Alma Faskaj. Të gjithë anëtarët e trupit gjykues dhe subjekti i rivlerësimit deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
9. Me vendimin nr. 2, datë 5.11.2019, trupi gjykues vendosi:
 - 9.1 Të përfundojë hetimin administrativ për të tria kriteret e parashikuara në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, kriterin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu.

9.2 Të miratojë rezultatet paraprake të hetimit.

9.3 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet paraprake të hetimit kryesisht, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016.

9.4. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtat e tij në përputhje me nenin 47, të ligjit nr.84/2016, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 – 40 dhe 45–47, të Kodit të Procedurave Administrative.

10. Në datën 14.11.2019 subjekti iu drejtua Komisionit me kërkesë dërguar në rrugë elektronike, për deklasifikimin e plotë të raportit të DSIK-së të datës 11.9.2019, i deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH me nr. ***, datë 11.9.2019.

11. Në datën 18.11.2019 subjekti vuri në dispozicion në rrugë elektronike, parashitësë me sqarime dhe dokumente shkresore bashkëngjitur shoqëruar me kërkesën me objekt vënien në dispozicion të akteve hetimore DSIK-së dhe kërkimi i rishikimit të raportit të figurës.

12. Në datën 22.11.2019 subjekti iu drejtua Komisionit me kërkesë, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 22.11.2019, me objekt riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e figurës.

13. Me vendimin nr. 3, datë 22.11.2019, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim tri kërkesat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vendosi mospranimin e tyre. Ky vendim i arsyetuar iu njoftua subjektit në datën 22.11.2019, së bashku me njoftimin për zhvillimin e seancës dëgjimore.

14. Në datën 2.12.2019 u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, sipas nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

15. Në datën 5.12.2019, trupi gjykues, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, dhe deklaroi të mbyllur seancën dëgjimore, në përfundim të së cilës, shpalli vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, sipas parashikimit të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1 VLERËSIMI I PASURISË

II.1.a Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private për vitet 2004 – 2017, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ”Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Në datën 27.1.2017, subjekti ka dorëzuar deklaratën e pasurisë “Vetting” në ILDKPKI, në përputhje me nenin 32/1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr.84/2016 dhe me aktin nr. *** prot., datë 16.4.2018, ka konkluduar se:

➤ deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;

- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

II.1.b Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, znj. Doreza Musabelliu, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaramet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarameve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarameve të pamjaftueshme, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ nga Komisioni, sipas neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me :

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

1. Në deklaratën “Vetting”:

1.1 Kursime nga paga dhe shpërblimet nga puna si prokurore në “Credins Bank”, në shumën 1.442.155,8 lekë, konfirmuar nga “Credins Bank”¹. Pjesa takuese: 100 %.

1.2. Kursime në *cash* nga paga dhe shpërblimet nga puna si prokurore, në shumën 500.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara.

2. Në deklaratat periodike:

^[1] “41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

¹Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.12.2018, nga “Credins Bank” në dosjen e Komisionit.

2.1 Në vitet 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, dhe 2011, subjekti ka plotësuar sipas parashikimeve ligjore deklaratat e interesave private periodike/vjetore, si person i vetëm në gjendjen familjare.

2.2 Në deklaratën periodike për vitin 2012, në rubrikën “rrethi i personave të lidhur”, subjekti ka deklaruar bashkëjetesën me z. G. D., sipas ndryshimeve të ligjit, por, nuk ka deklaruar interesat private që burojnë nga kjo bashkëjetese, sipas nenit 3, të ligjit nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, sipas të cilit në objektin e deklarimit të pasurive është shtuar detyrimi për të deklaruar “*interesat privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës*”.

2.3 Në deklaratën periodike për vitin 2013, në rubrikën “rrethi i personave të lidhur”, subjekti ka deklaruar bashkëjetesën me z. G. D., sipas ndryshimeve të ligjit, por, nuk ka deklaruar interesa privatë që burojnë nga kjo bashkëjetesë.

2.4 Në deklaratën periodike për vitin 2014, subjekti ka paraqitur në ILDKPKI deklaratën e bashkëjetuesit, z. G. D., i cili ka filluar të deklarojë për herë të parë pasuritë dhe interesat privatë, sipas ndryshimeve në ligj, duke vijuar deri në deklaratën “Vetting”.

E pyetur gjatë procesit në lidhje me periudhën e nisjes së bashkëjetesës së saj me shtetasin G. D., subjekti ka sqaruar² se: “... *marrëdhënia e bashkëjetesës ka nisur në vitin 2006 në apartamentin e blerë prej z. G. D., e cila u bë e qëndrueshme në vitin 2008...*”.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se në deklaratat periodike për vitet 2012 dhe 2013, subjekti nuk ka bërë deklarime në lidhje me pasuri të bashkëjetuesit G. D., të cilat janë të lidhura me interesat private të saj për shkak të bashkëjetesës, sipas ndryshimeve të ligjit nr. 85/2012, konstatim për të cilin subjektin iu kërkuan sqarime me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Lidhur me këtë konstatim, në parashtrimet e datës 18.11.2019, si dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka sqaruar hollësisht shkaqet e mosdeklarimit, pasqyruar shkurtimisht si vijojnë:

i) Në formularin e deklaratës së interesave private/periodike vjetore, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 20.3.2013, citohej se kjo deklaratë duhet të plotësohej nga personi i lidhur që janë bashkëshorti dhe fëmijët madhorë, dhe jo nga bashkëjetuesi.

ii) Në atë periudhë, nuk është informuar në mënyrë të plotë me ndryshimet ligjore, për shkak se në datën 28.3.2013, ka sjellë në jetë dy fëmijë binjakë, duke qëndruar me leje lindjeje një vit e një muaj.

iii) Ka gjykuar se nuk ishte detyrim ligjor deklarimi i dy pasurive të bashkëjetuesit, për shkak se ato kanë qenë 100 % në pronësi të tij.

Vlerësimi i Komisionit

i) Është e vërtetë se në “formularin e deklaratës së interesave privatë periodik/vjetor”, mungon të jetë shkruar fjala “*bashkëjetuesi*”, por në këtë formular, shkruhet që deklarimi duhet të bëhet edhe sipas ndryshimeve të ligjit nr. 85/2012, datë 18.9.2012, ku janë përfshirë interesat që rrjedhin prej bashkëjetesës.

² Shihni përgjigjet e pyetjeve shtesë në vazhdim të pyetesorit nr. 2, dërguar nga subjekti me *e-mail* në datën 5.3.2019, në dosjen e Komisionit.

ii) Me certifikatën familjare të datës 13.01.2017, administruar nga ILDKPKI³, vërtetohet fakti se znj. Doloreza Musabelliu ka sjellë në jetë dy fëmijë binjakë, në datën 28.3.2013, dhe si rrjedhim, për shkak të preokupimeve dhe të vështirësive në fillim të periudhës së mëmësisë, subjekti mund të ketë qenë në pamundësi objektive për t'u informuar në mënyrë të plotë me ndryshimet e ligjit dhe me detyrimet që rrjedhin prej tij.

iii) Lidhur me pretendimin sipas të cilit, subjekti ka gjykuar se nuk ishte detyrim ligjor deklarimi i pasurive tërësisht në pronësi të bashkëjetuesit, pas verifikimeve të deklaratave periodike, si dhe nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ, është vërtetuar se:

- të dyja pasuritë e deklaruara nga bashkëjetuesi i subjektit, z. G. D., pas vitit 2014, janë në pronësi të plote të tij;

- në asnjë rast si burim krijimi i këtyre pasurive, nuk kanë shërbyer të ardhura të subjektit të rivlerësimit;

- në asnjë rast subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime dhe nuk ka pasur transaksione bankare ose jo bankare që kanë lidhje me blerjen e pasurive dhe likuidimin e çmimit të blerjes;

- nuk u vërtetua që gjatë viteve 2012 dhe 2013, vite në të cilat subjekti nuk ka deklaruar pasuri të bashkëjetuesit, të ketë pasur në pronësi pasuri të ndryshme nga ato të deklaruara prej tij në deklaratën periodike për vitin 2014 dhe në vijim.

- i vetmi interes privat i buruar prej bashkëjetesës me z. G. D., sipas parashikimit të nenit 3, të ligjit nr. 85/2012, i ndryshuar, ka qenë që subjekti ka banuar në apartamentin e banimit në pronësi të bashkëjetuesit, fakt të cilin e ka deklaruar në deklaratat periodike për vitet 2012 dhe 2013.

Për sa më sipër, referuar nenit 3, të ligjit nr. 85/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, sipas të cilit, subjekti ka pasur detyrimin për të deklaruar "interesat privatë, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës", në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në të gjitha argumentet si më sipër, si dhe duke i konsideruar të arsyeshme pretendimet e subjektit, Komisioni vlerësoi se:

i) Në pikëpamjen substanciale, në deklaratat periodike për vitet 2012 dhe 2013, subjekti e ka deklaruar sipas ligjit të vetmin interes privat të rrjedhur nga bashkëjetesa me z. G. D., përdorimin e apartamentit në pronësi të plotë të tij, me sip. prej 124 m² në "****". Konkretisht, në të dyja deklaratimet, kjo pasuri është deklaruar si adrese banimi dhe subjekti ka deklaruar bashkëjetesën me shtetasin G. D.

ii) Në pikëpamjen formale, mungesa e deklarimeve të subjektit në lidhje me pasuri të bashkëjetuesit në deklaratat periodike për vitet 2012 dhe 2013, nuk ka pasur si qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo interesi privat të subjektit të rivlerësimit dhe as të bashkëjetuesit dhe si të tilla nuk janë konsideruar si shkak për penalizim të saj.

Pasuri të deklaruara nga personi i lidhur/ bashkëjetues, z. G. D

Z. G. D. ka filluar deklarimin për herë të parë në vitin 2014, sipas detyrimit të ligjit nr. 45/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar", duke deklaruar:

1. Apartament banimi, me sip. 124 m², blerë në datën 30.1.2006, në shumën 73.400 euro, ndodhur në "****" Tiranë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: hua e marrë nga babai, noter prej vitit 1999 - 2008.

1.1 Në lidhje me statusin juridik të kësaj pasurie, ka rezultuar se:

1.1.a ZVRPP Tiranë⁴ nuk e ka konfirmuar të regjistruar këtë pasuri.

³ Shihni Aneksin 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 19.10.2018, nga ZVRPP-ja Tiranë në dosjen e Komisionit.

Me qëllim verifikimin e shkaqeve të mosregjistrimit të pasurisë në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme, u pyet subjekti, si dhe u kërkua informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Në përgjigjet e pyetësorit të datës 19.04.2019, znj. Doloreza Musabelliu ka sqaruar se :... *“ky apartament është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, në tetor të vitit 2018 në emër të shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k.... arsyeja që kjo pasuri nuk është regjistruar ende në emër të z. G. D. është se ai nuk e ka blerë atë nga shoqëria ndërtuese, por e ka blerë nga pronari i truallit dhe për të bërë të mundur shitjen finale dhe regjistrimin në emër të blerësit është e nevojshme që të bëhet kontrata e shkëmbimit përfundimtar me pronarët e truallit, ku një pjesë e tyre kanë ndërruar jetë... ”.*

Subjekti, për të vërtetuar pretendimet e saj, ka paraqitur:

- deklaratë të datës 23.4.2019, të shtetasit K. S., administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit.
- vërtetim datë 26.4.2019, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, sipas të cilit apartamenti objekt shqyrtimi është i bllokuar në favor të pronarëve të truallit, deri sa të zgjidhen mosmarrëveshjet midis tyre në rrugë gjyqësore.

Pretendimet e subjektit, u vërtetuan të jenë të bazuara, sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria Vendore Tirana Jug⁵, e cila rikonfirmoi se apartamenti me numër pasurie ***, me sip.124.47 m² është në pronësi të shoqërisë “***” sh.p.k., dhe se pasuria është bllokuar deri në realizimin e kontratës së shkëmbimit, me urdhër kufizimi të datës 1.10.2018.⁶

1.1.b OSHEE-ja⁷ nuk konfirmoi kontratë të furnizimit me energji në emër të shtetasve Doloreza Musabelliu dhe G. D. në qytetin e Tiranës, por ka informuar se⁸ sipas sistemit të faturimit, kontrata e apartamentit objekt shqyrtimi, rezulton në emër të shtetasës R. Ll., vajza e shitësit të pasurisë, z. N. Ll., e hapur në datën 16.3.2006.

Duke qenë se ishte e paqartë përse kontrata me OSHEE-në nuk është lidhur në emër të blerësit G. D., pasi është lidhur kontrata me shitësin e pasurisë në vitin 2006, i janë kërkuar subjektit sqarime, e cila ka deklaruar⁹ se shkak për këtë ka qenë kërkesa nga ky institucion i një kontrate përfundimtare të shitjes, kontratë e cila nuk u vërtetua të jetë lidhur midis palëve, për shkaqe të pavarura nga bashkëjetuesi i subjektit, z. G. D. Në këto kushte, si dhe referuar praktikës së ndjekur nga OSHEE-ja, pretendimi i subjektit rezulton të jetë i bazuar.

1.2 Nga verifikimi i deklarimeve për pasurinë nuk u konstatuan pasaktësi dhe mospërpjethje në deklaratime, pasi:

1.2.a Në deklarinë për vitin 2014, z. G. D., ka deklaruar apartament banimi me sip. 124 m², me adresë: kulla ***, ap. ***, k. ***, blerë në datën 30.1.2006 nga shtetasi N. Ll., në shumën 73.400 euro. Burimi i krijimit: kontratë huaje nga shtetasi K. D. në datën 25.1.2006.

1.2.b Në deklaratën “Vetting” pasuria është deklaruar me të njëjtat deklaratime.

⁵ Shihni në dosje shkresën kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 10.6.2019, të Drejtorisë Vendore Tirana Jug.

⁶ Ky kufizim është bërë pas dërgimit të shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2017, të Drejtorisë së ALUIZNI-t TIRANA 2, në të cilën kërkohet: që në zbatim të pikave 14 dhe 16 të VKM-së nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara” të vendoset hipoteka ligjore në seksionin përkatës së kartelës së pasurisë së paluajtshme për sa i përket regjistrimit të ndërtimit për sipërfaqen që do të bëhet kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore me VKM.

⁷ Shihni shkresën kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 15.3.2019, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

⁸ Shihni shkresën kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 17.5.2009, të OSHEE-së në dosjen e Komisionit.

⁹ Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 19.6.2019, në dosjen e Komisionit.

1.3 Në lidhje me origjinën dhe përfitimin ligjor të pasurisë nga aktet në dosje,¹⁰ si dhe nga përgjigjet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit,¹¹ rezultoi se në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

1.3.a Në aneks kontratën e sipërmarrjes me nr. ***, datë 10.6.2004, midis shoqërisë ndërtimore “***” sh.p.k. dhe pronarëve të truallit (trashëgimtarë të familjes Ll.), është parashikuar që bashkëpronari i truallit shtetasi N. Ll., do të marrë nga shoqëria “***” sh.p.k., midis të tjerave edhe pasurinë objekt shqyrtimi, apartamentin me sip. 124 m², kulla ***, ap. ***, k. ***.

1.3.b Me kontratë kalimi kredie nr. ***, datë 30.1.2006, shtetasi N. Ll. në cilësinë e kreditorit i kalon shtetasit G. D kredinë e tij, që buron nga aneks kontrata e sipërmarrjes me nr. ***, datë 10.6.2004, me çmim 73.400 euro. Sipas kësaj kontrate marrja në dorëzim nga z. G. D. do të bëhet brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i aktit prej palëve. Duke qenë se ky procesverbal mungonte, iu kërkua subjektit ta vejë në dispozicion, e cila deklaroi se: “... për marrjen në dorëzim të apartamentit nuk është përpiluar një procesverbal dhe se apartamenti është marrë në dorëzim në datën e përpilimit të kontratës së kalimit të kredisë. Sipas saj, parashikimi në kontratë lidhur me përpilimin e procesverbalit të marrjes në dorëzim, është një parashikim tip i cili ka ekzistuar në kontratën e përpiluar prej noterit...”.

1.3.c Me vërtetimin e datës 26.4.2019, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, apartamenti objekt shqyrtimi, figuron i regjistruar në emër të shoqërisë “***” sh.p.k., dhe është i bllokuar në favor të pronarëve të truallit.

Për sa i përket çmimit të blerjes së pasurisë, referuar Udhëzimit nr. 5, datë 7.9.2006, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive”, dhe koeficientit “K” për vitin 2006, kosto e shitjes në lekë/m² të apartamenteve në tregun e lirë për qytetin e Tiranës, ka qenë në vlerën 79.615 lekë/m². Nisur nga kjo vlerë, një apartament me sip. 124 m², do të kushtonte 9.872.260 lekë. Z. G. D. e ka blerë në çmimin 73.400 euro ose 9.079.580 lekë, pra, 792.680 lekë më pak se çmimi referencë.

Me qëllim verifikimin e një konflikti të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shitësin e pasurisë apo familjarë të tij, iu kërkua Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, nëse subjekti e ka shqyrtuar çështjen ku palë pjesëmarrëse kanë qenë shtetasit N. Ll., R. Ll. dhe A. Ll., dhe ky institucion konfirmoi se ndaj këtyre shtetasve nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal apo hetim pasuror¹².

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me origjinën dhe përfitimin e pasurisë, u konstatua se:

i) Nuk ka pasur problematika, si dhe asnjë të dhënë nga cilido burim, që të vejë në dyshim përfitimin e paligjshëm të pasurisë nga bashkëjetuesi i subjektit, z. G. D.

ii) Nuk ka pasur asnjë të dhënë dhe dyshim që ky shtetas të jetë trajtuar preferencialisht për blerjen e pasurisë, për shkak të pozitës së subjektit të rivlerësimit, dhe blerja e pasurisë nga shtetasi N. Ll., në vlerën 792.680 lekë më pak se çmimi referencë, ka qenë për shkak të vullnetit të lirë të palëve kontraktuese.

1.4 Në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes:

Në kontratën për kalimi kredie me nr. ***, datë 30.1.2006, është parashikuar se çmimi kontraktor prej 73.400 euro, do të lëvrohet i plotë në datën e nënshkrimit të kontratës prezente.

¹⁰ Shihni aktet në aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹¹ Shihni përgjigjet në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dhe dokumentacionin bashkëngjitur, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 7.3.2019, në dosjen e Komisionit.

¹² Shihni shkresë nr. ***prot., D. B., datë 15.5.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në dosjen e Komisionit.

Me qëllim vërtetimit e faktit të likuidimit të çmimit të shitjes, nga blerësi G. D. në favor të shitësit N. Ll., dhe mënyrën e likuidimit iu kërkuan subjektit sqarime dhe dokumente shkresore, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: “...kjo shumë është depozituar nga bashkëjetuesi, z. G. D., në llogarinë e R. Ll., pranë Intesa Sanpaolo Bank. Në datën 30.1.2006, z. G. D., ka tërhequr nga llogaria e tij shumën 73.400 euro, dhe pasi kjo shumë i është dorëzuar shtetasës R. Ll., është depozituar në cash prej saj, në datën 30.1.2006, me përshkrimin “shitje apartamenti 2+1”. Bashkëjetuesi më ka sqaruar se likuidimi është bërë në këtë mënyrë (tërheqje kesh dhe pastaj depozim në llogari) dhe jo me transfertë bankare, për të mos paguar interesat që mban banka për trasfertat bankare...”.

Deklarimet e subjektit vërtetohen me informacionin e marrë nga “Intesa Sanpaolo Bank”¹³ e cila konfirmoi: (i) derdhje në llogarinë e z. G. D., në shumën totale 74.900 euro, deri në datën 25.1.2006; (ii) tërheqje prej tij në datën 30.1.2006, ditë kur është lidhur kontrata, të shumës prej 73.400 euro; (iii) kalimin në cash të shumës prej 73.400 euro, në llogari të znj. R. Ll. (vajza e shitësit, z. N. Ll.), me përshkrimin “shitje apartamenti 2+1”.

Pas konstatimit se shuma prej 73.400 euro, nuk ka kaluar në rrugë bankare në llogari të znj. R. Ll., subjektit iu kërkuan sqarime. Në parashtrimet e saj të datës 18.11.2019, subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime si ato të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit, duke deklaruar se likuidimi është bërë në këtë mënyrë (pra, tërheqje cash nga banka dhe pastaj depozitim në llogari), për të mos paguar interesin/komisionin që mban banka për veprime të tilla, pretendim të cilin Komisioni e konsideroi të arsyeshëm, bazuar në të gjitha provat, si dhe referuar faktit që nuk ka ndonjë përcaktim ligjor që i ndalon individët për të kryer tërheqje vlerash monetare në cash dhe më pas derdhje në cash.

Në lidhje me faktin se përse çmimi i shitjes prej 73.400 euro, nuk ka kaluar në llogari të shitësit, z. N. Ll., por në llogari të vajzës së tij, znj. R. Ll., subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime, e cila në përgjigjet e pyetësorit të dytë, si dhe të pyetësorit të datës 19.6.2019, ka deklaruar dhe ka argumentuar se znj. R. Ll., vajza e N. Ll., është marrë me veprimet e likuidimit të çmimit të shitjes, pasi babai i saj, ishte në moshë të madhore dhe i sëmurë.

E pyetur se përse shtetasi N. Ll. nuk e ka shprehur vullnetin e tij, në lidhje me këtë fakt, gjatë redaktimit të kontratës së kalimit të kredisë, subjekti sqaron se: “...për arsye të gjendjes jo të mirë shëndetësore tij, ka qenë noteri i cili pasi ka përpiluar kontratën e kalimit të kredisë, ka shkuar në shtëpinë e Nexhatit për ta njohur atë me kontratën dhe për ta nënshkruar atë.... Kjo kontratë ende nuk është finalizuar me kontratën përfundimtare dhe se kalimi i çmimit nga G. D. tek R. Ll. është bërë bazuar në pëlqimin e dhënë prej fëmijëve të N., asnjëri prej këtyre personave nuk ka paraqitur ndonjë pretendim lidhur me likuidimin e çmimit të shitjes”.

Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka depozituar:

- deklaratë të datës 30.1.2006¹⁴, sipas së cilës, fëmijët e z. N. Ll. shtetasit R. Ll. dhe A. Ll., konfirmojnë dakortësinë e shitësit N. Ll., për kalimin e çmimit të shitjes në emër të vajzës së tij, znj. R. Ll.

- deklaratë noteriale me nr. ***, datë 25.4.2019, e shtetasës R. Ll. dhe e bashkëshortit të saj, z. S. L., ku deklarohet se në periudhën e përpilimit dhe të nënshkrimit të kontratës së shitjes, shtetasi N. Ll., nuk ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore, dhe për këtë arsye, ashtu sikurse është parashikuar në deklaratën e datës 30.1.2006, shuma prej 73.400 euro ka kaluar në llogarinë e saj. Kjo deklaratë, edhe pse është hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, së bashku me deklaratën e datës 30.1.2006, merren në konsideratë si prova që nuk vërtetojnë kontestime të shitësit të pasurisë, si dhe të trashëgimtareve të tij ligjore, lidhur me likuidimin e çmimit të shitjes së pasurisë.

¹³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018, të “Intensa Sanpaolo Bank”.

¹⁴ Shihni dokumentet bashkangjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

- lëvizjet e llogarisë bankare pranë “Intensa Sanpaolo Bank”, ku konstatohet se në datën 30.1.2006, znj. R. Ll. ka derdhur në llogarinë e saj pranë kësaj banke, shumën prej 73.400 euro me përshkrimin “cash depozitë R. Ll., shitje apartamenti 2+1”.

Veç sa më sipër, Komisioni i referohet edhe informacionit të vënë në dispozicion nga OSHEE-ja, sipas të cilit, abonent i energjisë elektrike pranë kësaj kompanie, nuk është shitësi i pasurisë, shtetasi N. Ll., por vajza e tij, znj. R. Ll., fakt që hedh dritë mbi pretendimin e subjektit, se veprimet që kanë pasur lidhje me pasurinë objekt shqyrtimi, janë kryer prej kësaj të fundit, në pamundësi të babait të saj, për shkaqe shëndetësore.

Në përfundim të procesit, në kushtet kur, u vërtetua që: (i) çmimi i shitjes së pasurisë është paguar tërësisht prej blerësit G. D.; (ii) nuk ka pasur asnjë pretendim të shitësit apo trashëgimtareve të tij ligjore në lidhje me likuidimin; si dhe (iii) nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim i ligjshëm në lidhje me pagimin e çmimit të shitjes së pasurisë, duke i vlerësuar bindëse argumentet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk ka pasur dyshime për likuidimin total të çmimit të blerjes apo kryerjen e veprimeve të paligjshme nga bashkëjetuesi i subjektit, z. G. D., për blerjen e pasurisë.

1.5 Në lidhje me burimin e krijimit të çmimit të blerjes së pasurisë, shumës prej 73.400 euro

Si burim krijimi është deklaruar hua e marrë prej z. G. D., nga babai i tij, z. K. D., në shumën 75.000 euro, me kontratë huaje nr. ***, datë 25.1.2006¹⁵, pa interes dhe me afat 6-vjeçar që fillon nga data 1.9.2005 – 31.8.2011. Shuma e huas është marrë cash jashtë zyrës noteriale.

Pasi subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumente që të provojnë mënyrën e marrjes në dorëzim të shumës prej 75.000 euro nga huadhënësi, z. K. D., në përgjigje të pyetësorit të dytë, ajo ka deklaruar se : “...z. K. D. ia ka dhënë cash këtë sasi bashkëjetuesit të saj, në disa këste në qytetin e Fierit, duke filluar nga data 1.9.2005, kësti i parë i huas 20.000 euro, deri në datën 25.1.2006, kësti i fundit në shumën 8.400 euro. Këto sasi eurosh, shtetasi G. D. i ka depozituar në Bankën Amerikane (në atë kohë sot Intesa Sanpaolo Bank) ku bilanci në datën 25.1.2006 (e cila është data e kontratës së huas) sipas statement të Intesa Sanpaolo Bank është 73.474,19 euro”.

Këto pretendime të subjektit, u verifikuan nga “Intesa Sanpaolo Bank”¹⁶, e cila konfirmon derdhje në data të ndryshme në llogarinë e z. G. D. në shumen totale 74.900 euro, deri në datën 25.1.2006, pesë ditë përpara lidhjes së kontratës, datë 30.1.2006, si në tabelën më poshtë:

DATA	SHUMA
2.9.2005	20.000,00 euro
6.9.2005	20.000,00 euro
9.9.2005	9.500,00 euro
22.12.2005	2.000,00 euro
24.1.2006	15.000,00 euro
25.1.2006	8.400,00 euro
TOTAL	74.900,00 euro

Siç vihet re në këtë tabelë, në muajin shtator 2005, në llogari të z. G. D., është depozituar shuma prej 49.500 euro, ndërsa në muajin janar 2006, është depozituar shuma prej 23.400 euro. Për shkak se ishte e paqartë mënyra se si huadhënësi, z. K. D., ka siguruar këto shuma brenda një

¹⁵ Shihni aktin në aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2018 të “Intesa Sanpaolo Bank”, në dosjen e Komisionit.

muaji, si dhe përse këto shuma nuk janë dhënë njëherazi, por në data të ndryshme, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këto konstatime.

Në parashtrimet e datës 18.11.2019, ashtu si dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka sqaruar se nuk bëhet fjalë për shuma të krijuara brenda një muaji, por shumat e sipërpërmendura, janë të akumuluar ndër vite nga aktiviteti i babait të bashkëjetuesit të subjektit, z. K. D. si noter, të cilat disponoheshin prej tij në formë *cash*, gjë që ligji nuk e ndalonte. Ndërkohe, sipas saj, dhënia e shumave me këste dhe jo njëherësh, është bërë për shkaqe sigurie, pasi ato janë dhënë jashtë sistemit bankar, si dhe dorëzimi ka qenë i kushtëzuar nga kursi i këmbimit të euros.

Në përfundim të procesit, në kushtet kur: (i) u vërtetua që shumat e depozituara *cash* nga shtetasi K. D., kanë kaluar në llogari të djalit të tij, z. G. D., në mënyrën si u deklarua nga subjekti i vlerësimit; si dhe (ii) nisur nga fakti që gjatë hetimit administrativ, nuk është vërtetuar asnjë rrethanë që të lidhë subjektin e rivlerësimit me shtetasin K. D. dhe me të ardhurat e tij, Komisioni i çmoi bindëse argumentet e znj. Doloreza Musabelliu, dhe nuk konstatoi asnjë lidhje shkakësore midis veprimeve/mosveprimeve të subjektit dhe të mënyrës se si shtetasi K. D., i ka kaluar shumat e depozituara ndër vite në *cash*, në llogari të djalit të tij, z. G. D..

1.6. Lidhur me mundësinë financiare për dhënien e huasi nga shtetasi K. D., me cilësinë e personit të lidhur, janë kryer disa veprime hetimore në përfundim të të cilave, rezultoi se:

1.6.a Me lejen e ushtrimit të profesionit nr. 212, datë 5.4.1999¹⁷, z. K. D., i është dhënë leja për ushtrimin e profesionit të noterit me qendër në qytetin e Fierit.

1.6.b Të ardhurat e z. K. D. si person fizik (qarkullim), për të cilat janë paguar detyrimet tatimore për periudhën 1999 – 2005¹⁸, janë përmbledhur në tabelën më poshtë:

Te ardhura 1999-2005	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	TOTAL 1999-2005
Qarkullim sipas zyrës së tatimeve dhe bashkisë Fier	2.000.000	3.250.000	2.000.000	3.500.000	3.500.000	3.500.000	3.500.000	21.250.000

Për periudhën 1999 – 2006, tatimpaguesi K. D. nuk ka detyrime tatimore të papaguara ndaj administratës tatimore.

1.6.c Z. K. D., deri në janar 2006, ka disponuar pasuri të luajtshme e të paluajtshme, përfshirë dhe huan e dhënë djalit të tij (më 25.1.2006), që në total kapin vlerën 16.624.963 lekë, si në tabelën më poshtë:

Data	Pasuri të K. D.	Shuma në lekë
24/02/2003	Dyqan me sip. 45 m ²	2.000.000
24/02/2003	Apartament me sip. 140 m ²	3.000.000
24/02/2003	Garazh me sip. 26 m ²	300.000
31/12/2004	Likuiditete në “Raiffeisen Bank”	2.134.463
30/01/2006	Dhënë hua djalit 75.000 euro	9.190.500
	Shuma	16.624.963

Për të analizuar burimet e ligjshme për dhënien e huas prej 75.000 euro nga shtetasi K. D., është kryer analiza e burimeve të tij në raport me pasuritë e krijuara, deri në ditën e dhënies së huas datë 25.1.2006. Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare, për të vërtetuar fitimin neto

¹⁷ Shihni dokumentin në aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁸ Shihni bashkëngjitur me përgjigjet e pyetësorit, datë 26.2.2019, me shkresën nr. **** prot., datë 28.2.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, në dosjen e Komisionit.

të aktivitetit të z. K. D. si noter, Komisioni i është referuar dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit¹⁹, të cilat vërtetojnë shpenzime dhe të ardhura të personit fizik “K. D.” gjatë periudhës 1999 – 2005, dokumente sipas të cilave, norma e fitimit të këtij biznesi, varion nga 85-92 % të qarkullimit. Por, duke pasur në konsideratë se biznesi i z. K. D., mund të ketë pasur edhe shpenzime të tjera përveç atyre të paraqitura, Komisioni vlerësoi që gjatë analizës financiare, norma e fitimit të llogaritet 80 % e qarkullimit.

Sipas analizës financiare, të ardhurat e ligjshme të z. K. D. për periudhën 1999 – 2005, kanë qenë në vlerën 17.891.390 lekë, ndërsa pasuria e vënë deri më 31.1.2006, duke përfshirë dhe huan në shumën 75.000 euro, ka qenë 16.624.963 lekë. Pra, shtetasi K. D., ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme, për dhënien e huas prej 75.000 euro, djalit të tij z. G. D..

Në analizën financiare janë përfshirë vetëm të ardhurat e z. K. D., dhe jo të ardhurat e bashkëshortes se tij, znj. R. D., konfirmuar nga Instituti Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Fier²⁰, duke marrë në konsideratë që të ardhurat e saj janë përdorur për shpenzime jetese.

1.7 Në lidhje me huan si detyrim financiar ndaj shtetasit K. D.:

Nga deklaratimet periodike dhe deklarata “Vetting”, rezultoi se:

i) Në deklaratimet periodike për vitet 2012 dhe 2013, subjekti nuk e ka deklaruar këtë hua dhe asnjë interes tjetër privat të buruar nga bashkëjetesa, siç është përmendur më sipër në këtë vendim.

ii) Në deklaratën periodike për vitin 2014, bashkëjetuesi i subjektit, z. G. D., ka deklaruar kontratën e huas me nr. ***, datë 25.1.2006, në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, si dhe ka deklaruar huan si burim krijimi të pasurisë objekt shqyrtimi, por nuk e ka deklaruar huan si detyrim financiar ndaj babait të tij, shtetasit K. D..

iii) Në deklaratën periodike për vitin 2015, subjekti dhe bashkëjetuesi i saj nuk kanë deklaruar asnjë fakt lidhur me këtë hua.

iv) Në deklaratën për vitin 2016, subjekti dhe bashkëjetuesi i saj, kanë deklaruar shlyerjen e një pjese të huas në shumën 2.500.000 lekë, ndërkohe që nuk është deklaruar detyrimi i pashlyer. Në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, bashkëjetuesi ka deklaruar kontratën e huas.

v) Në deklaratën “Vetting”, bashkëjetuesi i subjektit, z. G. D., ka deklaruar si detyrim të pashlyer të huas, shumën prej 55.018 euro.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, janë konstatuar pasaktësi në deklaratat periodike për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015, pasi subjekti dhe bashkëjetuesi i saj nuk kanë deklaruar detyrimin financiar ndaj shtetasit K. D., sipas parashikimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, pasaktësi për të cilat subjektit iu kërkuan sqarime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në parashtrimet e datës 18.11.2019, por edhe në seancë dëgjimore, znj. Doreza Musabelliu, ka sqaruar se:

i) në vitet 2012, 2013 dhe 2015, subjekti nuk e ka deklaruar këtë hua, pasi ajo ishte marrë personalisht prej bashkëjetuesit të saj, për të blerë një pasuri 100 % në pronësi të tij;

ii) në deklaratën periodike vjetore për vitin 2015, nga bashkëjetuesi i subjektit nuk është deklaruar në lidhje me këtë hua, pasi në deklaratën periodike vjetore për vitin 2014, kjo hua

¹⁹ Shihni dokumentet bashkangjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 dhe aneksit 33 të ILDKPKI-së.

²⁰ Shihni shkresën me nr. *** prot., datë 16.4.2019, në dosjen e Komisionit.

është deklaruar prej tij si burim krijimi në rubrikën “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, si dhe është deklaruar në rubrikën “të dhëna konfidenciale”. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2015, nuk kishte pasur asnjë ndryshim për t’u deklaruar;

(iii) në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, subjekti ka deklaruar shlyerjen e detyrimit në vlerën prej 2.500.000 lekësh, me vullnetin e saj të lirë, ndërkohë që nuk ka pasur asnjë detyrim për ta shlyer, pasi ky detyrim i takonte bashkëjetuesit. Ndërkohë, bashkëjetuesi i subjektit, z. G. D., nuk e ka deklaruar detyrimin e pashlyer, duke menduar se diferenca mes vlerës së huas dhe sasisë së shlyer është pjesa e mbetur e detyrimit.

E pyetur gjatë seancës dëgjimore lidhur me afatin gjashtëvjeçar të kontratës së huas, subjekti shpjegoi se pas momentit të përpilimit të kontratës nuk ka pasur bisedime të tjera, pasi afati i parashikuar në kontratë ka qenë një afat formal dhe duke qenë një marrëdhënie at dhe bir, midis palëve nuk ka pasur probleme për ta shlyer huan sa më shpejt.

Vlerësimi i Komisionit

Kontrata e huas e lidhur me akt noterial të datës 25.1.2006 është me afat gjashtëvjeçar, duke filluar nga 1.9.2005 deri më 31.8.2011. Fakti që për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015 nuk ka pasur deklarime të detyrimit financiar ndaj shtetasit K. D., mund të çojë në dyshimin se huaja është shlyer brenda vitit 2011 (afati i kontratës), ose brenda viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

Për t’u qartësuar në lidhje me këtë dyshim, Komisioni analizoi provat dhe faktet si vijojnë:

Së pari: deklaratat periodike të cilat sipas pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si prova dhe konkretisht:

i) Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2012 dhe 2013, subjekti i rivlerësimit, nuk ka kryer deklarime në lidhje me pasuritë e bashkëjetuesit, veç të tjerash edhe për shkak se huaja prej 75.000 euro për blerjen e apartamentit ishte marrë prej bashkëjetuesit të saj, për blerjen e një pasurie 100 % në pronësi të tij. Gjatë hetimit administrativ u vërtetua se, i vetmi interes privat që buron nga marrëdhëniet e bashkëjetuesës, sipas nenit 3, të ligjit nr. 85/2012, është bashkëpërdorimi i apartamentit objekt shqyrtimi, fakt të cilin subjekti e ka deklaruar si adresë banimi në deklaratën periodike për vitet 2012 dhe 2013. Në asnjë rast nuk u vërtetua që subjekti të jetë përfshirë në transaksione apo procedura ligjore për marrjen e huas apo për blerjen e pasurisë. Si rrjedhim, Komisioni çmon se mosdeklarimi nga subjekti i detyrimit financiar buruar nga marrëdhënia e huas, midis bashkëjetuesit të subjektit dhe babait të tij, në deklaratat vjetore për vitet 2012 dhe 2013, nuk mund të konsiderohen si prova për të vërtetuar se huaja është shlyer gjatë këtyre viteve.

ii) Në deklarinimin periodik për vitin 2014, vit në të cilin bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit, z. G. D., i ka lindur detyrimi për deklarinimin e interesave pasurore, është përmendur kontrata e huas e datës 25.1.2006, edhe pse në rubrikën “të dhëna konfidenciale”. Gjithashtu, huaja prej 75.000 euro, është deklaruar si burim për blerjen e apartamentit. Është e vërtetë që në deklarinimin për këtë vit, ky shtetas nuk ka deklaruar detyrimin financiar ndaj babait të tij, z. K. D., por gjithashtu, ai nuk ka deklaruar asnjë shumë të shlyer të huas, sipas detyrimit të parashikuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Këto fakte, janë tregues, që vërtetojnë mundësinë e shtyrjes së afatit të kontratës me marrëveshja të palëve.

iii) Në deklarinimin për vitin 2015, është e vërtetë që nuk është deklaruar huaja si detyrim financiar, por, në këtë deklarinim, nuk është deklaruar shlyerja e huas tërësisht apo në një pjesë të saj, sipas detyrimit ligjor. Ky fakt, gjithashtu është tregues, që vërteton mundësinë e shtyrjes së afatit të kontratës me marrëveshje të palëve.

iv) Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, është deklaruar shlyerja e një pjese të huas, ndërkohë nuk është deklaruar pjesa e detyrimit të pashlyer sipas ligjit, por që nënkuptohet.

v) Në deklaratën “Vetting”, është deklaruar detyrimi financiar në vlerën 55.018 euro ndaj shtetasit K. D..

Së dyti: deklarata noteriale me nr. ***, datë 11.10.2016²¹, e shtetasve K. D. dhe G. D., e cila është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI së bashku me deklaratën “Vetting”, konfirmon vijimin e marrëdhënies së huas së vitit 2006 midis tyre, si dhe shlyerjen e një pjese të saj në shumën prej 2.500.000 lekësh, në datën 11.10.2016, duke nënkuptuar shtyrjen e afatit të huas, veprim për të cilin dispozitat përkatëse të Kodit Civil për kontratën e huas, nuk parashikojnë detyrimisht një akt shkresor.

Së treti: gjatë hetimit administrativ, nuk u administrua asnjë provë që të hedhë dritë mbi dyshimin se huaja prej 75.000 euro, është shlyer përpara vitit 2016.

Së katërti: Komisioni nuk e anashkalon faktin që pikërisht për shkak të marrëdhënies së ngushtë at e bir, midis palëve në kontratë, në kushtet kur bashkëjetuesi i subjektit ka ndihmuar aktivitetin e babait të tij, për vite me radhë, si dhe nisur nga fakti se është në traditën shqiptare ndihma që prindërit u bëjnë fëmijëve në momentin e shpëputjes nga trangu familjar, huaja prej 75.000 euro, mund të ishte falur nga huadhënësi, shtetasi K. D., përpara vitit 2016, dhe në këtë rast as subjekti dhe as bashkëjetuesi i saj nuk do të kishin pasoja. Por, përkundër këtij fakti, në deklaratën për vitin 2016 dhe në vijim, bashkëjetuesi i subjektit ka pranuar dhe e ka deklaruar huan si detyrim financiar ndaj babait të tij.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në provat dhe në argumentet si më sipër, nuk u vërtetua shlyerja e huas prej 75.000 eurosh, ose një pjese të saj, përpara vitit 2016. Nga të gjitha rrethanat, nënkuptohet që marrëdhënia e huas është shtyrë me marrëveshja të heshtur të palëve, at e bir. Por, ndërkohe që, në deklaratat për vitet 2012–2015, huaja nuk është deklaruar si detyrim financiar, në deklaratën për vitin 2016, në deklaratën “Vetting”, dhe në vijim, në deklaratën për vitin 2017²², subjekti dhe bashkëjetuesi i saj, kanë pranuar dhe kanë deklaruar detyrimin financiar. Si rrjedhim, mosdeklarimi i detyrimit financiar i bashkëjetuesit të subjektit, z. G. D., ndaj babait të tij, z. K. D., sipas detyrimit të parashikuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, mbetet pasaktësi formale gjatë plotësimit të deklaratave periodike vjetore të pasurive për vitet 2012 – 2015, e cila nuk ka sjelle asnjë pasojë. Si e tillë, ajo nuk mund të konsiderohet nga Komisioni si pamjaftueshmëri në deklarime nga subjekti, dhe si rrjedhim, si shkak për penalizim të subjekti, aq më tepër në kushtet kur, nuk u vërtetua asnjë lidhje midis subjektit dhe pasurisë apartament banimi, me burim huan prej 75.000 euro, blerë nga bashkëjetuesi i saj, në vitin 2006, vit në të cilin, sapo kishin filluar bashkëjetesën.

2. Automjet tip “Volkswagen Passat”, viti i prodhimit 2005, me targa ***, i blerë në datën 29.6.2009, në shumën 10.000 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhura nga puna e babait, z. K. D., si noter për periudhën 1999 – 2008. Ndërkohë, në rubrikën “të dhëna konfidenciale” si burim krijimi të mjetit, janë deklaruar dhe të ardhurat si avokat të babait për periudhën 1994 – 1998.

Lidhur me këtë mjet DPSHTRR-ja²³ informon se shtetasi G. D., ka pasur të regjistruar në emër të tij automjetin me targa TR 5624S, nga data 30.6.2009 deri më 14.6.2018, kur e ka shitur me kontratë shitblerje nr. ***, datë 7.6.2018 (pas deklaratës “Vetting”). Këtë mjet e ka blerë me kontratë shitblerje nr. ***, datë 29.6.2009, nga shtetasi I. D., në vlerën 10.000 euro.

2.1 Në deklaratimet periodike të bashkëjetuesit të subjektit, z. G. D., u konstatua se:

²¹ Shihni aktin në aneksin nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

²² Shihni deklaratën periodike vjetore për 2017 në dosjen e ILDKPKI-së.

²³ Shihni shkresat kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.10.2018. dhe nr. *** prot., datë 19.10.2018, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

i) Në deklarinimin për vitin 2014, është deklaruar automjet tip “Volkswagen, blerë në datën 29.6.2009, në vlerën 10 000 euro, në pjesë takuese 100 %, me burim të ardhurat nga puna si avokat”.

ii) Në deklaratën “Vetting” është deklaruar automjet tip “Volkswagen” me të njëjtat deklarime, por, me burim të ardhura nga puna e babait, z. K. D..

Për sa më sipër, janë konstatuar mospërputhje të deklarimeve në lidhje me burimin e blerjes së mjetit në deklaratën për vitin 2014 dhe në deklaratën “Vetting”. Ndërkohë, ka qenë e paqartë nëse shuma prej 10.000 euro është dhuruar apo ka qenë hua e dhënë prej z. K. D..

Gjithashtu, në lidhje me këto konstatime, është pyetur subjekti dhe iu kërkua të vërtetojë mënyrën e kalimit të shumës prej 10.000 euro nga z. K. D. te z. G. D..

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 (pyetja 2) dhe atij të datës 9.6.2019 (pyetja 4), duke pranuar faktin se z. K. D. i ka dhënë hua bashkëjetuesit të subjektit, z. G. D., shumën prej 12.000 euro, subjekti ka sqaruar se: “ ... në deklaratën e vitit 2014 është bërë një lapsus,burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat e punës së babait të bashkëjetuesit si noter në qytetin e Fierit prej vitit 1998 – 2008..... Shuma prej 10.000 euro, i është dhënë cash pa dokument shkresor bashkëjetuesit të saj si ndihmë financiare, për shkak të ndihmës që ai i ka dhënë babait të tij në zyrën e tij të noterisë, pa u dokumentuar me ndonjë akt të posaçëm. duke qenë se ky automjet i ka shërbyer familjes, dhe meqenëse G. D. ka shlyer pjesërisht këtë shumë me të ardhurat e realizuara si avokat në 2009 – 2010, kjo marrëdhënie financiare është konsideruar e shuar mes tyre.....kjo ka qenë arsyeja e lapsusit në deklaratat periodike të G., i cili ka shënuar si burim të ardhurat e punës si avokat, pasi në atë kohë marrëdhënia financiare midis të dyve është konsideruar e shuar.... Bashkëngjitur gjeni deklaratën e zotit K. D., që vërteton huan në shumën prej 12.000 euro....”

Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. ***, datë 6.3.2019, të z. K. D., në të cilën ai ka deklaruar se i ka dhënë djalit të tij, z. G. D., në cash huan prej 12.000 euro, që në muajin qershor të vitit 2009, të padokumentuar me deklaratë në atë periudhë, pasi ende nuk kishte shlyer huan e parë të vitit 2006.

Pra, gjatë procesit të rivlerësimit subjekti i qëndron deklaratës “Vetting” se si burim për blerjen e mjetit në shumën prej 10.000 euro, kanë shërbyer të ardhura të z. K. D. nga aktiviteti si noter, të dhëna hua prej tij në shumën prej 12.000 euro, në vitin 2009, kur është blerë mjeti, hua e cila nuk është përmendur në deklaratën “Vetting”. Ndërkohë, sipas parashikimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka pasur detyrimin të paraqiste një deklaratë të re dhe të detajuar në përputhje me ligjin, ku të përcaktohej saktësisht burimi i krijimit të mjetit, huaja prej 12.000 euro, e cila më pas do të kontrollohej nga ILDKPKI-ja. Po kështu, sipas parashikimit të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti duhet që së bashku me deklaratën e re të pasurisë, të paraqiste dokumente që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive²⁴.

Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me burimin e krijimit të automjetit tip “Volkswagen”, blerë në datën 29.6.2009 është konstatuar se : (i) ka mospërputhje të deklaratës “Vetting” me deklaratën e vitit 2014, dhe me deklarimet gjatë procesit të rivlerësimit; dhe (ii) deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” nuk ka qenë në përputhje me ligjin.

Për sa i përket analizës financiare të të ardhurave që kanë shërbyer si burim për blerjen e mjetit me çmimin prej 10.000 euro, Komisioni, i ndodhur në kushtet e dy deklarimeve të ndryshme, atë të vitit 2014 dhe të deklaratës “Vetting”, i cili mbështetet edhe nga deklarimet gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në kushtet kur vlerësimi përfundimtar lidhur me faktin se cili ka qenë

²⁴ Shihni vendimin nr. 47, datë 25.7.2018, të Komisionit.

burimi i saktë i krijimit të mjetit, do të bëhej në përfundim të procesit, ka kryer analizë financiare në dy variante, si vijon:

- sipas deklaramit për vitin 2014:

Pasi është konstatuar se z. G. D., ka pasur një qarkullim prej 2.000.000 lekësh për periudhën mars 2009 - mars 2010, nga analiza financiare, dukej se ky shtetas, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në muajt mars–qershor 2009, për blerjen e mjetit në vlerën 10.000 euro.

- sipas deklaratës “Vetting”:

Nga analiza financiare është konstatuar se gjatë periudhës 2006–2009, shtetasi K. D., ka pasur të ardhura në shumën prej 4.864.000 lekësh.

Lidhur me mundësinë e bashkëjetuesit të subjektit, z. G. D., për shlyerjen e huas, pasi është konstatuar se : (1) në periudhën mars 2009 - mars 2010, ka pasur qarkullim në shumën prej 2.000.000 lekësh; (2) për vitet 2011 dhe 2012 nuk ka pasur aktivitet; si dhe (3) për vitin 2013, fitimi i tij ka qenë në vlerën 763.424 lekë – dukej se, bashkëjetuesi i subjektit, z. G. D., ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme të periudhës 2009 – 2013, për të shlyer të gjithë huan prej 12.000 euro.

Subjektit iu kalua barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve si më sipër, sipas parashikimit të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në parashtrimet gjatë procesit, ashtu sikurse edhe në seancë dëgjimore, znj. Doloreza Musabelliu ka dhënë të njëjtat sqarime, duke këmbëngulur në faktin që huaja prej 12.000 euro me të ardhura nga puna të z. K. D., e cila ka shërbyer si burim për blerjen e mjetit, është shlyer pjesërisht nga bashkëjetuesi me të ardhura nga puna si avokat në vitet 2009 – 2010, vite në të cilat marrëdhënia e huas është shuar me marrëveshje të palëve. Sipas subjektit kjo është arsyeja e lapsusit në deklaramin për vitin 2014.

Lidhur me pasaktësinë në deklaratën “Vetting”, për shkak të mosdeklarimit specifikisht të huas si burim i krijimit të automjetit, subjekti sqaroi se këto janë deklarime të bashkëjetuesit të saj dhe se nuk është përfshirë në asnjë moment në këtë marrëdhënie huaje apo shlyerje, dhe as ka ndërhyrë ndonjëherë në marrëdhëniet e tyre, qoftë familjare apo financiare, pasi automjeti është në pronësi 100 % të bashkëjetuesit të saj.

Vlerësimi i Komisionit

Bazuar në të gjitha provat e grumbulluara, Komisioni i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, se z. K. D., i ka dhënë një hua prej 12.000 euro djalit të tij, z. G. D., në vitin 2009, me të ardhura nga puna si noter (hua e pavërtetuar me një dokument shkresor, pasi nuk ka qenë detyrim ligjor), e cila ka shërbyer si burim në momentin e blerjes së mjetit, shpjegime të cilat mbështeten edhe nga:

i) deklarata “Vetting” ku si burim janë deklaruar të ardhura të këtij shtetasi;

ii) deklarata noteriale e shtetasit K. D., më 6.3.2019, e cila edhe pse është një deklaratë e redaktuar gjatë procesit të rivlerësimit, është vlerësuar si provë që vërteton mungesën e pretendimeve të këtij shtetasi lidhur me huan. Për më tepër, fakti që vlera e huas në këtë kontratë është më e lartë se çmimi i blerjes së mjetit, e bën këtë akt me të besueshëm. Gjatë analizës financiare, shuma e detyrimit ligjor ndaj shtetasit K. D., nga bashkëjetuesi subjektit, z. G. D., është llogaritur huaja në shumën prej 12.000 euro, dhe jo vetëm çmimi i blerjes së automjetit prej 10.000 euro.

Më tej, nga verifikimi i deklaratave periodike të shtetasit G. D., vërehet se në deklaratën periodike për vitin 2014, kur atij i lindi detyrimi për të deklaruar, kjo hua nuk është deklaruar prej tij, pasi marrëdhënia e huas ishte shuar, pikërisht për shkak të shlyerjes së saj (plotësisht

ose pjesërisht, në rastin e marrëveshjes mes palëve për faljen e një pjese të saj, sipas subjektit) me të ardhura nga puna të tij si avokat përpara këtij viti, të ardhura që në këtë deklaram, janë deklaruar si burim krijimi i mjetit.

Veç sa më sipër, pavarësisht deklarameve formalisht të ndryshme lidhur me burimin e krijimit të mjetit, Komisioni konstatoi se deklarimi për vitin 2014 (të ardhura nga puna si avokat të z. G. D.) dhe deklarimi për “Vetting” (të ardhura nga puna si noter të z. K. D.), në thelb janë të njëjta, pasi në të dyja rastet është e qartë se si burim i mirëfilltë për blerjen e mjetit kanë shërbyer të ardhurat e z. G. D. nga puna si avokat, me të cilat është shlyer huaja prej 12.000 eurosh, e përdorur si burim në momentin e blerjes së mjetit. Pra indirekt, të ardhurat e z. G. D., kanë shërbyer për blerjen e mjetit, sipas deklarimit për vitin 2014. Për këtë arsye, me të drejtë subjekti pretendon se deklarata për vitin 2014 ka qenë një lapsus në deklaram.

Bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet më sipër, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se si burim fillestar për blerjen e automjetit, kanë shërbyer të ardhura nga puna e z. K. D., ashtu sikurse është deklaruar në deklaramtën “Vetting”, dhënë hua z. G. D.t në vlerën prej 12.000 euro në momentin e blerjes së mjetit, në vitin 2009, dhe shlyer prej tij me të ardhura nga avokatia, pas këtij viti.

Por, fakti që huaja nuk është deklaruar në mënyrë specifike si burim i mjetit në deklaramtën “Vetting”, e bën këtë deklaramtë të pasaktë, pasi sipas parashikimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, në deklaramtën “Vetting”, subjekti ka pasur detyrimin të paraqiste një deklaramtë të re dhe të detajuar në përputhje me ligjin, ku të përcaktohej saktësisht çdo pasuri dhe burimi i krijimit të tyre.

Lidhur me këtë pasaktësi, Komisioni arsyeton se, pavarësisht se në deklaramtën “Vetting” nuk është deklaruar specifikisht huaja si burim për blerjen e mjetit, në këtë deklaramtë, janë deklaruar të ardhura nga puna të huadhënësit K. D. si noter që kanë shërbyer si burim për huan, si rrjedhim, është deklaruar burimi i të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e mjetit në çmimin 10.000 euro, në momentin e blerjes. Nisur nga ky konstatim, si dhe referuar faktit se gjatë hetimit administrativ, u vërtetua mundësia financiare me të ardhura të ligjshme të z. K. D. për dhënien e huas prej 12.000 euro, Komisioni e vlerësoi pasaktësinë si formale dhe që nuk ka sjellë asnjë pasojë.

2.2 Lidhur me mundësinë financiare të z. K. D. për dhënien e huas prej 12.000 euro:

Për të analizuar burimet e ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore për dhënien e huas prej 12.000 euro nga z. K. D., është kryer analiza e burimeve të tij në raport me pasuritë e krijuara, për periudhën janar 2006 – 2009 (huaja është dhënë më 29.6.2009), pasi të ardhurat përpara kësaj periudhe janë përfshirë në analizën financiare për dhënien e huas në shumën prej 75.000 euro, në janar të vitit 2006 (trajtuar me sipër gjatë analizimit të burimit të apartamentit).

Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare, për të vërtetuar fitimin neto të aktivitetit të z. K. D., si noter, Komisioni i është referuar dokumenteve të administruara nga ILDKPKI-ja, si dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit²⁵, të cilat vërtetojnë shpenzime dhe të ardhura të personit fizik “K. D.” gjatë periudhës 2006 – 2009, dokumente sipas të cilave, norma e fitimit të këtij biznesi, varion nga 93 – 96 % të qarkullimit. Por, duke pasur në konsideratë se biznesi i z. K. D., mund të ketë pasur edhe shpenzime të tjera, përveç atyre të paraqitura, Komisioni vlerësoi që gjatë analizës financiare, norma e fitimit të llogaritet 80 % e qarkullimit.

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier për vitin 2006, personi fizik “K. D.” ka pasur të ardhura (qarkullim) në shumën 3.000.000 lekë për të cilin është paguar tatimi mbi fitimin. Ndërsa për vitin 2007, sipas aktedetyrimit nr. ***, për

²⁵ Shihni Aneksin nr. 33 të ILDKPKI-së dhe dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 e në dosjen e Komisionit.

detyrimin e taksës vendore për vitin 2007, qarkullimi i aktivitetit ka qenë në vlerën 3.200.000 lekë.

Nga analiza financiare, si në tabelën më poshtë, rezulton se të ardhurat e ligjshme të shtetasit K. D. për periudhën 2006 – 2009, kanë qenë në vlerën 4.864.000 lekë, ndërkohë që huaja prej 12.000 euro ose 1.646.040 lekë, është dhënë më 29.6.2009.

Të ardhura 2006-2009	2006	2007	2008	2009	TOTAL
Qarkullim	3.000.000	3.200.000	0	0	6.200.000
Fitim me normë 80%	2.400.000	2.464.000	0	0	4.864.000

Gjatë hetimit administrativ, nga të dhënat e vëna në dispozicion prej DPPP²⁶, pas verifikimeve, u konstatua se z. K. D., ka porositur një apartament banimi në Vlorë, me çmim 66.000 euro, të paguara *cash* në ditën e lidhjes së subjektit, tre muaj pasi ka dhënë hua në shumën prej 12.000 euro. Pra, në total pasuria e vënë nga ky shtetas për periudhën 2006 – 2009, ka qenë në vlerën 78.000 euro.

Pavarësisht se në momentin e dhënies së huas prej 12.000 euro, shtetasi K. D., ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për dhënien e saj, referuar jurisprudencës të Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁷, Komisioni ka kryer disa veprime hetimore, me qëllim verifikimin e çdo lidhjeje të subjektit dhe të bashkëjetuesit të saj me apartamentin e banimit në Vlorë, si dhe heqjen e çdo dyshimi për pronësinë apo posedimin e mundshëm të tyre mbi këtë pasuri, si vijojnë:

2.2.a ZVRPP-ja Vlorë nuk konfirmoi ndonjë pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëjetuesit të saj në qytetin e Vlorës²⁸.

2.2.b OSHEE-ja nuk konfirmoi kontratë të furnizimit me energji elektrike të lidhur në emër të subjektit të rivlerësimit dhe z. G. D. në instancën e Vlorës²⁹.

2.2.c OSHEE-ja konfirmoi kontratë të furnizimit me energji elektrike të lidhur në emër të shtetasit K. D. në lagjen “****”, Vlorë, me datë hapje 30.6.2009³⁰.

2.2.d Subjekti, pasi u pyet në lidhje me këtë pasuri, ka shpjeguar se:³¹ “...sipas deklarimeve të bashkëjetuesit të saj, kjo pronë është porositur prej shtetasit K. D., për llogari të vajzës të tij që jeton në Amerikë, znj. F. R. Si burim të ardhurash, kanë shërbyer një hua prej 40.000 eurosh dhënë nga motra e zotit K. D., zonjës N. I. dhe bashkëshortit të saj J. I., të cilët merren me biznes në qytetin e Fierit, si dhe pjesa tjetër me kursimet e K. D. ndër vite nga puna si avokat e si noter...”.

Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti, ka vënë në dispozicion³²:

- kontratë porosie, nr. ***, datë 8.9.2009, sipas të cilës z. K. D., ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., apartament me vlerë 66.000 euro, me adresë: Lagjia “****”, Vlorë;

²⁶ Shihni shkresë kthim përgjigjeje, nr. ***prot., datë 5.3.2019, nga DPPP-ja, në dosjen e Komisionit.

²⁷ Shihni vendim nr. 15, datë 17.7.2019, dhe vendim nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

²⁸ Shihni shkresë kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 5.3.2019, nga ZVRPP-ja Vlorë dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.10.2019 nga ASHK Vlorë, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shihni shkresë kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 15.3.2019, nga OSHEE-ja dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.10.2019, nga OSHEE në dosjen e Komisionit.

³⁰ Shihni shkresë kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 15.3.2019, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

³¹ Shihni përgjigjet dhe dokumentacionin e dërguar nga subjekti në datën 26.3.2019, në dosjen e Komisionit.

³² Shihni dokumentet bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit të datës 19.6.2019, në dosjen e Komisionit.

- deklaratë noteriale, datë 27.6.2019, e shtetasve J. dhe N. I., të cilët deklarojnë dhënien e huas z. K. D. në shumën 40.000 euro, në vitin 2009;

- shkresë nr. **** prot., datë 27.6.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, sipas të cilës, fitimi i realizuar për vitet 2000 – 2009 nga subjekti “****” sh.p.k., me administrator, z. J. I., është në vlerën 358.490.574 lekë.

2.2.e U verifikuan lëvizjet e shtetas F. R, dhe nga të dhënat e sistemit *TIMS*, u konstatua se një shtetase me gjeneralitetet e saj, nuk rezultoi të ketë hyrë në territorin shqiptar pas datës 29.7.2009.

2.2.f Nuk u konstatua ndonjë akt shkresor, si dhe asnjë transaksion bankar ose jo bankar në emër të subjektit apo bashkëjetuesit të saj, z. G. D., që të ketë lidhje me apartamentin e banimit në Vlorë, blerë prej z. K. D..

Pavarësisht se bazuar në provat e sipërpërmendura, në përfundim të hetimit administrativ, nuk u konstatua asnjë fakt e rrethanë që të lidhë subjektin e rivlerësimit si dhe bashkëjetuesin e saj, me pasurinë e blerë në Vlorë, nga shtetasi K. D., me qëllim një vlerësim sa më objektiv të çështjes, nisur nga rrethanat si vijojnë:

1) tre muaj pasi ka dhënë huan prej 12.000 eurosh, shtetasi K. D. ka paguar vlerën 66.000 euro për blerjen e apartamentit, pra, në total brenda periudhës 2006 – 2009, ka paguar vlerën 78.000 euro;

2) nuk ka një kontratë huaje që të vërtetojë në kohë reale dhënien e huas në vlerën prej 40.000 euro nga znj. N. I. te z. K. D.;

3) sipas një të dhëne të marrë nga sistemi *TIMS*, një shtetase me emër F. R. banuese në Amerikë, nuk rezultoi të ketë ardhur në Shqipëri pas datës 29.7.2009.

subjektit të rivlerësimit, në lidhje me konstatimet e mëposhtme, iu kalua barra e provës:

i) Shtetasi K. D. nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për krijimin e vlerës prej 78.000 euro gjatë periudhës 2006 – 2009, dhe për rrjedhojë është e paqartë nëse shuma e të ardhurave të tij të ligjshme prej 4.864.000 lekë, ka shërbyer për dhënien e huas prej 12.000 euro në datën 29.6.2009.

ii) Është e paqartë përse pasuria e porositur nga z. K. D., në Vlorë, është paguar në vlerën 66.000 euro me të ardhura të motrës së tij, znj. N. J., për vajzën e tij, znj. F. R., banuese në Amerikë, e cila që prej datës 29.7.2009, nuk ka të dhëna që të ketë hyrë në territorin shqiptar dhe për të cilën nuk ka asnjë fakt e rrethanë që e lidh atë me këtë pasuri.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në parashtrimet e saj pas marrjes dijeni për rezultatet e hetimit, por dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka pretenduar se :

... pasuria apartament i blerë në Vlorë në muajin shtator të vitit 2009 prej shtetasit K. D., nuk duhet përfshirë në analizën financiare, pasi në këtë mënyrë i jepet një kuptim shumë i zgjeruar personit të lidhur, duke e kthyer atë në të njëjtën pozitë me subjektin e rivlerësimit.....

... detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të gjitha pasurive të personit tjetër të lidhur, e vendos atë në pozita të pabarabarta me subjektet, persona të tjerë të lidhur të të cilëve, janë persona që janë rezidentë jashtë Republikës së Shqipërisë. Në këto raste verifikimi i komisionit është shtrirë vetëm në nivelin e të ardhurave të ligjshme të siguruara prej tyre, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pa bërë hetim për investimet e tyre, apo për të gjitha pasuritë e krijuara prej tyre.....

... Marrëdhënia midis tij (shtetasit K. D.) dhe motrës së tij N. I., është tepër e veçantë vëlla e motër. Ata kanë një lidhje shumë të fortë mes tyre dhe kjo lidhje nuk është zbehur edhe pas krijimit të familjeve respektive, duke qënë se vazhdojnë të banojnë në të njëjtin qytet, në Fier.... Në vitin 2009 kishte ardhur vajza e tij F. R. e tij dhe kishin biseduar për një shtëpi, së bashku

dhe me motrën e tij N. ku kjo e fundit kishte shprehur gadishmërinë ta ndihmonte F..... Nisur nga gjendja ekonomike shumë e mirë e shtetases N. dhe J. I. nuk krijohet asnjë dyshim mbi origjinën e këtyre të ardhurave. Madje duhet theksuar fakti se J. I. ashtu edhe babai i tij S. I. kanë bërë edhe bamirësi duke dhuruar të mira materiale për njerëzit që nuk i njohin por që janë në nevojë...

... shtetasja F. R. ka ardhur në vijimësi në vitet 2009, 2013, 2016, 2018 dhe 2019, së bashku me bashkëshortin e saj A. I. R., dhe vajzën S. R., vërtetuar kjo me raportet e sitemit TIMS..... Këtë pretendim, subjekti e ka vërtetuar me të dhëna të marra nga sistemi TIMS, sipas të cilave shtetasja F. K. R. ka pasur hyrje-dalje nga Shqipëria në vitet 2009, 2013, 2016 dhe 2018.

Në vijim, subjekti i rivlerësimit i referohet vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe konkretisht vendimit nr. 20, datë 31.7.2019, dhe vendimit nr. 15, datë 17.7.2019, sipas të cilave, hetimi në lidhje me vlerësimin e burimit të ligjshëm të dhënies së huave, duhet të bëhet brenda periudhës së dhënies së tyre, pa u shtrirë ky detyrim për pasuri të vëna pas këtij momenti, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur. Në mënyrë të argumentuar, subjekti pretendoi se ajo dhe bashkëjetuesi i saj, nuk kanë asnjë lidhje me pasurinë e blerë në Vlorë nga z. K. D..

Veç sa me sipër, subjekti pretendoi se z. K. D., gjatë periudhës 2007 – 2008, ka pasur të ardhura në shumën prej 2.200.000 lekë, periudhë për të cilën, sipas dokumentacionit që dispononte Komisioni, të ardhurat e tij ligjore kanë qenë zero. Subjekti, lidhur me fitimin e realizuar nga ky shtetas gjatë kësaj periudhe, paraqiti:

- shkresë nr. *** prot., datë 5.3.2019, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashki, e cila informon se pagesat e taksave në vitet 2007 – 2008, nuk janë të dokumentuara në arkivë apo ndonjë regjistër, pra, sipas subjektit, ajo është në pamundësi për të dokumentuar me shkresë zyrtare të ardhura të ligjshme të shtetasit K. D., gjatë kësaj periudhe.

- fotokopje të njehsuar me origjinalin të regjistrimit noterial të shtetasit K. D., të sekretuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, si dhe atë përpilimit të 17 testamenteve përgjatë vitit 2008, ku nga mbledhja e shumave përkatëse të çdo veprimi noterial të kryer gjatë vitit 2008, si edhe të vlerës së testamenteve, rezultojnë të paktën 2.200.000 lekë qarkullim.

Vlerësimi i Komisionit

Sipas pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, persona të lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të dhëna hua. Në referim të kësaj dispozite ligjore, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit përmbushi detyrimin ligjor për të justifikuar burimin e huas prej 12.000 euro, me të ardhura të ligjshme të personit të lidhur, z. K. D., referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

1) Në datën 26.9.2009, kur është blerë mjeti, z. K. D., i ka dhënë djalit të tij, bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit, shumën prej 12.000 euro, ndërkohë që të ardhurat ligjore të këtij shtetasi gjatë periudhës janar 2006 – 26.9.2009, kanë qenë në vlerën 4.864.000 lekë.

2) Në datën 8.9.2009, z. K. D., ka porositur një apartament banimi në Vlorë, për të cilat ka paguar vlerën prej 66.000 euro. Pasi u kryen të gjitha veprimet verifikuese, në përfundim të procesit:

(i) nuk u vërtetua asnjë fakt e rrethanë që të lidhë subjektin e rivlerësimit dhe bashkëjetuesin e saj me apartamentin e banimit në Vlorë blerë nga shtetasi K. D.;

(ii) nuk u administrua asnjë provë që të vërtetojë dyshimet mbi pronësinë apo posedimin e mundshëm nga ana e tyre të kësaj pasurie.

3) Në vlerësimin përfundimtar të çështjes Komisioni i është referuar:

i) vendimit 20/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ...për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur.... ;

ii) vendimit 15/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se, analiza financiare e të ardhurave ligjore të shtetasit K. D., që kanë shërbyer si burim për dhënien e huas në vlerën prej 12.000 euro, duhet të shtrihet brenda periudhës së dhënies së huas, në rastin konkret brenda datës 29.6.2009. Duke qenë se të ardhurat e tij ligjore nga muaji janar 2006 – 29.6.2009, kanë qenë në vlerën 4.864.000 lekë, shtetasi K. D., ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme, për dhënien e huas prej 12.000 euro.

2.3 Në lidhje me mundësinë financiare të bashkëjetuesit të subjektit, z. G. D., për shlyerjen e huas prej 12.000 euro:

Subjekti pretendoi se, shlyerja e huas është bërë pjesërisht në vitet 2009 – 2010, me të ardhura nga puna si avokat të bashkëjetuesit të subjektit, z. G. D., duke nënkuptuar që një pjesë e huas është falur, gjë që ka sjellë shuarjen e marrëdhënies së huas. Duke qenë se ky pretendim është deklarativ dhe i pambështetur në ndonjë dokument shkresor në kohë reale, Komisioni ka kryer analizë financiare të të ardhurave të tij për periudhën 2009–2013, nisur nga fakti se në vitin 2014, kur ai ka deklaruar për herë të parë pasuritë e tij, z. G. D., nuk ka deklaruar asnjë detyrim ligjor ndaj shtetasit K. D..

Për periudhën mars 2009 – mars 2010, z. G. D. ka pasur qarkullim në vlerën 2.000.000 lekë. Duke qenë se Komisioni nuk ka pasur të dhëna për fitimin neto, nisur nga lloji i aktivitetit, ky fitim është llogaritur në masën 80 % të qarkullimit. Për vitet 2011 dhe 2012, z. G. D., nuk ka pasur aktivitet. Ndërsa për vitin 2013, fitimi ka qenë në vlerën 763.424 lekë.

Në total, referuar të ardhurave të zotit G. D. për periudhën 2009-2013, përmbledhur në tabelën më poshtë, rezultoi se, ai ka pasur mundësi për të shlyer detyrimin prej 12.000 euro, me të ardhura të ligjshme.

Përshkrimi	2009 – 2010	2013	TOTAL
Qarkullim	2.000.000		
Fitim neto 80 %	1.600.000	763.424	2.363.424

3. Kursime *cash* nga të ardhurat nga puna si noter në vlerën 500.000 lekë, lejuar me urdhrin nr. 255, datë 13.6.2012, të Ministrit të Drejtësisë. Pjesa takuese: 100 %.

Nga analiza financiare ka rezultuar se z. G. D. ka pasur mundësi financiare për të krijuar kursimet në *cash* të deklaruara³³.

Detyrime financiare

Në deklaratën “Vetting”, bashkëjetuesi i subjektit, z. G. D., ka deklaruar detyrimin financiar kundrejt z. K. D., në vlerën prej 55.018 euro. Në rubrikën “detyrime financiare”, është deklaruar: shlyer detyrimi në mënyrë të pjesshme në vlerën 2.500.000 lekë ose 18.382 euro, me burim kursime *cash* të bashkëjetueses, znj. Doloreza Musabelliu, nga paga si prokurore dhe kursime nga puna si noter.

Lidhur me shlyerjen e detyrimit në vlerën prej 2.500.000 lekë, u konstatua se:

i) Me deklaratë noteriale nr. 3372/2034, datë 11.10.2016³⁴, huadhënësi K. D., pranon shlyerjen e huas së dhënë në shumën prej 2.500.000 lekë me kontratë huaje, datë 25.1.2006,. Sipas sqarimeve të subjektit³⁵, shuma prej 2.500.000 lekësh është dhënë dorazi, pasi ky ishte vullneti i huadhënësit.

ii) Në deklaratën periodike për vitin 2016, është deklaruar shlyerja e detyrimit në vlerën prej 2.500.000 lekësh.

Me qëllim verifikimin e burimit me të ardhura të ligjshme të vlerës prej 2.500.000 lekësh, është bërë analizë financiare bazuar në burimet e deklaruara të ardhurave, pasurive e shpenzimeve për vitin 2016, si në tabelën më poshtë, nga ku rezultoi se, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi i saj, nuk kanë pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të shlyer tërësisht huan në vlerën 2.500.000 lekë, për shkak të një difference prej 289.482 lekësh.

	2016
PASURI	-1.838.439
SHTESA/PAKËSIME LIKUIDITETE	-1.838.439
DETYRIME	-2.500.000
Kthim huaje bashkëjetuesi K. D. për blerje apartamenti	-2.500.000
PASURI NETO (PASURI-DETYRIME)	661.561
TË ARDHURA dokumentuar	2.008.589
Të ardhura nga paga subjekti	1.610.917
Të ardhura nga bashkëjetuesi	397.672
SHPENZIME	1.636.510
Shpenzime arredimi shtëpie	500.000
Shpenzime udhëtimi	196.142
Shpenzime jetese	940.368
Analiza dokumentuar (Të ardhura-pasuri neto-shpenzime)	-289.482

Me rezultatet e hetimit, subjektit iu kalua barra e provës për të vërtetuar të kundërtën sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016. Në parashtrimet e saj, subjekti pretendoi se për shlyerjen e kësaj shume kanë shërbyer të ardhurat e saj dhe të bashkëjetuesit të kursyera në formë *cash* ndër vite nga viti 2005 deri në vitin 2016. Këtë pretendim, Komisioni e vlerësoi të pabazuar, pasi në analizën financiare janë përfshirë kursimet e viteve të kaluara të deklaruara nga subjekti si të

³³ Shihni tabelën përmbledhëse në këtë vendim.

³⁴ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, të datës 26.2.2019, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 7.3.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁵ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, të datës 26.2.2019, në dosjen e Komisionit.

pakësuara në vitin 2016, për shlyerje detyrimi (të pasqyruara në rreshtin e parë në tabelën më sipër, si “pakësime kursime në shumën 1.838.439 lekë”).

Në lidhje me balancën negative prej 289.482 lekësh, në vlerësimin tërësor të çështjes, dhe në proporcionalitet me të gjitha konstatimet gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk e çmon atë, si shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

ANALIZA FINANCIARE

Gjatë hetimit administrativ është bërë një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare, të deklaruara nga znj. Doloreza Musabelliu dhe bashkëjetuesi i saj, duke i krahasuar ato me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore. Kjo analizë, për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	PASURI	DETYRIME	PASURI NETO (PASURI-DETYRIME)	TË ARDHURA dokumentuar	SHPENZIME	Të ardhura-pasuri neto-shpenzime
2004	0	0	0	189.212	273.964	-84.752
2005	406.340	0	406.340	1.044.779	289.557	348.882
2006	9.579.573	9.277.725	301.848	1.096.860	219.114	575.898
2007	108.763	0	108.763	1.182.328	285.331	788.234
2008	231.415	0	231.415	1.281.850	273.240	777.195
2009	1.574.088	446.040	1.128.048	2.594.520	328.240	1.138.232
2010	661.833	138.445	523.388	1.909.256	960.024	425.844
2011	292.643	-221.263	513.906	1.416.597	338.999	563.692
2012	348.013	-75.995	424.008	1.336.557	761.303	151.247
2013	720.645	-241.187	961.832	1.710.355	586.738	161.785
2014	100.228	0	100.228	2.315.448	894.003	1.321.217
2015	508.961	0	508.961	2.365.564	897.104	959.499
2016	-1.838.439	-2.500.000	661.561	2.008.589	1.636.510	-289.482
TOTAL	12.694.064	6.823.765	5.870.299	20.451.915	7.744.126	6.837.490

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare: Credins Bank³⁶; Raiffesien Bank³⁷; Intesa Sanpaolo Bank³⁸; Credins Invest³⁹; si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti⁴⁰.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2018, nga “Credins Bank”.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2018, nga “Raiffeisen Bank”.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2018, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 9.10.2018, nga Credins Invest.

⁴⁰ Shihni deklaratimet përditë të çdo viti, në dosjen e ILDKPKI-së.

- i) të ardhurat nga pagat e subjektit në: Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës Parë për Krime të Rënda⁴¹ Tiranë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore;⁴²
- ii) të ardhura të bashkëjetuesit: si noter⁴³;
- iii) të ardhura të babait të bashkëjetuesit, z. K. D.⁴⁴.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- i) shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së NJEF, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT);
- ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata brenda Europës. Për udhëtimet jashtë Europës shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur në vlerën 700 euro vajtje ardhje. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi. Në rastet kur subjekti ka deklaruar se ka qëndruar te të afërm shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 20 euro/ditë;
- (iii) shpenzime arredimi të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga Komisioni;
- (iv) shpenzime për interesa kredie, si dhe shpenzime të tjera të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të nisur nga Komisioni.

ç. Në vlerat e kredisë dhe të shlyerjes së saj⁴⁵.

d. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive⁴⁶.

KONSTATIME TË TJERA

Përveç hetimit administrativ në lidhje me pasuritë e deklaruara nga bashkëjetuesi i subjektit si më sipër, nga Komisioni janë kryer hetime, në lidhje me faktet, si vijojnë:

1. Pas verifikimit të udhëtimeve në sistemin *TIMS* është pyetur subjekti i rivlerësimit për identitetin e saktë të pronarëve, për secilin prej automjeteve të përdorura për udhëtimet jashtë shtetit, duke sqaruar marrëdhënien e saj dhe të bashkëjetuesit, me secilin prej tyre. Subjekti ka dhënë përgjigje të detajuara në lidhje me këto automjete dhe pronarët e tyre, duke vënë në dispozicion dhe dokumentacion provues⁴⁷.

Me qëllim evidentimin e kontakteve të papërshtatshme, janë kryer veprime verifikuese në lidhje me përfshirjen në veprimtari të krimit të organizuar nga personat me të cilët subjekti dhe bashkëjetuesi i saj kanë udhëtuar. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka informuar⁴⁸ se për këta shtetasve nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal apo hetim pasuror.

Veç sa më sipër, për shtetasin M. C., me të cilin ka udhëtuar bashkëjetuesi i subjektit, ka pasur informacione se ka qenë person i përfshirë në krimin e organizuar në shtetin italian. Pasi janë

⁴¹ Shkresë *** prot., datë 16.1.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë për Krime të Rënda Tiranë.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2016, Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

⁴³ Shkresë nr. *** prot., datë 7.3.2019, të Bashkisë Tiranë, shkresë nr. 41581/1 prot., datë 15.8.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.2.2019, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

⁴⁵ Shkresë me nr. *** prot., datë 24.12.2018, nga "Credins Bank".

⁴⁶ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁷ Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 09.05.2019, dërguar nga subjekti i rivlerësimit në rrugë elektronike në datën 16.5.2019, në dosjen e Komisionit

⁴⁸ Shihni shkresë me nr. *** prot., D. B., datë 15.5.2019 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit të datës 9.5.2019, në dosjen e Komisionit.

kryer kërkime, është konstatuar se shtetasi M. C. i proceduar penalisht në Itali, nuk ka qenë i njëjtë me shtetasin M. C., të cilin kishte udhëtuar z. G. D.⁴⁹.

2. Lidhur me adresat e banimit:

Subjektit iu kërkuan sqarime se me çfarë statusi kishte banuar në adresën: Rr. “****”, p. ***, sh. ***, ap. ***, të deklaruar në deklaratën për vitin 2004, dhe në deklarinimin periodik për vitin 2005, e cila sqaroi⁵⁰ se: “ unë kam deklaruar në deklarinimet e mia të vitit 2004 dhe 2005 si adresë banimi të plotë adresën ‘****, p. ***, sh. ***, ap. *** . Sqaroj se në këtë adresë unë kam qëndruar me qira për vlerën mujore 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë lekë) (përfshirë në analizën financiare.) Shtetasja e cila ma ka lëshuar me qira është F. A. e cila ishte nga Gjirokastra. Banesa ka qenë e vajzës dhe të dhëndrit të saj të quajtur përkatësisht A. L. dhe V. L. Marrëdhënia ime me këtë apartament si dhe me personin që e ka lëshuar me qira është shkëputur rreth muajit prill- maj të vitit 2006, dhe pavarësisht se unë nuk banoj më në zonën që mbulon Njësia Administrative Nr. ***, por banoj në zonën që mbulon njësi administrative nr. ***, nuk e kam ndryshuar njësinë administrative të gjendjes civile, për arsye të procedurave që kërkojnë kohë. Bashkëjetuesi im figuron me gjendje civile në njësinë administrative nr. *** Tiranë ku është dhe apartamenti që ai ka blerë”.

Në vijim, subjektit iu kërkua të vërë në dispozicion dokumentet e pronësisë në emër të A. e V. L., si dhe dokumente që vërtetojnë se nuk ka pasur çështje në shqyrtim me këtë shtetas. Në përgjigjet e saj⁵¹ subjekti vuri në dispozicion:

- dokument nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, sipas të cilës banesa me adresë: Rr. “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, është në pronësi të A. E. L. dhe V. Th. L., pajisur me certifikatë pronësie në datën 26.8.2005;

- informacionin e vënë në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, nëpërmjet të cilit, konfirmohet se ndaj shtetasve A. E. L. dhe V. Th. L., nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë procedim penal apo hetim pasuror.

Për sa me sipër, nuk ka pasur dyshime në lidhje me adresën e deklaruar nga subjekti për vitet 2004 dhe 2005, si dhe nuk u vërtetua që subjekti të ketë pasur konflikt interesi me pronarët e apartamentit.

3. OSHEE-ja⁵² ka informuar se në emër të z. G. D. është lidhur kontrata e furnizimit me energji ***, në instancën Fier, dhe kontrata *** në instancën Shkodër.

Në lidhje me këto informacione, rezultoi se: (i) në rastin e kontratës në instancën e Fierit, kabina ndodhet në fshatin ***, Fier, por nuk ka të dhëna mbi gjeneralitetet e abonentit. Nga verifikimi në regjistrin e gjendjes civile, me gjeneralitet G. D., rezultoi një shtetas i datëlindjes 1975, nga fshati ***, ndërkohë që bashkëjetuesi i subjektit është i datëlindjes 1977; (ii) në rastin e kontratës në instancën e Shkodrës, kabina ndodhet në *** Shkodër dhe abonentit ka numrin personal ***. Nga verifikimi në regjistrin e gjendjes civile, rezultoi se dhe atësia e këtij shtetasi, është R.. Këto të dhëna nuk përputhen me gjeneralitetet e bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit, atësia e të cilit është Kovaç.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, u vërtetua se të dhënat si më sipër të OSHEE-së, nuk i përkasin subjektit të rivlerësimit.

4. Pasi u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka pasur gjeneralitete të ndryshme nga ato të deklaruara në deklaratën “Vetting”, konkretisht emri ka qenë “Doloresa” dhe është bërë “Doloreza” dhe mbiemri ka qenë “Musabelli” dhe është bërë “Musabelliu”, u pyet subjekti mbi

⁴⁹ Shihni e-mail-in e datës 10.7.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵⁰ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të subjektit, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 7.3.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵¹ Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 19.06.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵² Shihni shkresën me nr. *** prot., datë 15.3.2019, të OSHEE-së, në dosjen e Komisionit.

qëllimin dhe periudhën e këtyre ndryshimeve, e cila sqaroi se⁵³: “... gjatë gjithë jetës së saj ka përdorur gjeneralitetet Doloreza Musabelliu, nga shkolla fillore në *** Skrapar e deri në Shkollën e Magjistraturës, duke i vërtetuar këto fakte me diplomat përkatëse. Më tej ajo deklaroi se ka ndryshuar ligjërisht emrin nga Doloresa në Doloreza në datën 2.6.2009 dhe mbiemrin nga Musabelli në Musabelliu në datën 07.04.2010... Ndryshimi është bërë për shkak se në ZGjC ***, në të cilën ajo është rregjistruar për herë të parë, emri i saj figuronte Doloresa dhe mbiemri Musabelli...”. Subjekti vërtetoi ndryshimet në rrugë ligjore të emrit dhe mbiemrit, me certifikatën familjare të datës 26.09.2019⁵⁴.

Me qëllim evidentimin e pasurive të mundshme në pronësi të subjektit me gjeneralitetet e mëparshme, iu kërkua informacion të gjitha institucioneve që kanë lidhje me pasuri dhe të drejta reale të pronësisë. Asnjë prej institucioneve, nuk konfirmoi pasuri në emër të subjektit me gjeneralitetet Doloresa Musabelli⁵⁵.

II.2 KONTROLLI I FIGURËS

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, duke vënë në dispozicion:

1. Raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Doloreza H. Musabelliu, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 2.4.2019, në konkluzion të të cilit, është konstatuar përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza H. Musabelliu.

2. Raportin vijues me të dhëna shtesë dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 11.9.2019, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 11.9.2019, në konkluzion të të cilit, DSIK-ja ka ndryshuar konstatimin fillestar për subjektin e rivlerësimit, znj. Doloreza H. Musabelliu, nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vijimin e ushtrimit të detyrës.

Në lidhje me plotësimin e formularit të deklaramentit:

Gjatë plotësimit të formularit për kontrollin e figurës, pyetjes: *Nëse keni pasur emër tjetër më parë?*, subjekti i është përgjigjur me “po”, dhe ka dhënë shpjegime të hollësishme për ndryshimin e emrit nga “Doloresa” në “Doloreza” dhe mbiemrit nga “Musabelli” në “Musabelliu”. Pasi është pyetur në lidhje me këto ndryshime, subjekti ka vënë në dispozicion deklarime dhe dokumente⁵⁶, me anën e të cilave vërtetoi ndryshimet ligjore të emrit dhe të mbiemrit, si dhe shkaqet e këtyre ndryshimeve.

Në përfundim të hetimit administrativ, u vërtetua që subjekti i rivlerësimit ka plotësuar me korrektesë dhe vërtetësi formularin për kontrollin e figurës.

Në lidhje me përshtatshmërinë për vijimin e ushtrimit të detyrës:

Sipas informacionit të deklasifikuar në raportin e DSIK-së, për subjektin e rivlerësimit ka pasur dyshime lidhur me: (i) përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe ndërveprimit korrupsiv; si dhe (ii) në lidhje me dekonspirimin e një informacioni të klasifikuar.

Pavarësisht konstatimeve të raportit të dytë të DSIK-së, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të figurës për znj.

⁵³ Shihni përgjigjet e subjektit dërguar me e-mail në datën 25.9.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵⁴ Shihni dokumentin bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit të datës 25.9.2019 në dosjen e Komisionit.

⁵⁵ Shihni shkresën kthim përgjigje nga ASHK e DPSHTRR-ja pas datës 30.9.2019 në dosjen e Komisionit.

⁵⁶ Shih dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të subjektit të datës 25.9.2019, në dosjen e Komisionit.

Doloreza Musabelliu, që nuk bazohet dhe as është i detyruar të bazohet në përfundimet e paraqitura nga DSIK-ja.

Nga verifikimi pranë organeve ligjzbatuese, trupi gjykues mori dijeni se informacionet e raportit të dytë të DSIK-së, kanë të bëjnë me hetime në ngarkim të shtetasit M. M., për të cilin ka dyshime se është disponuar me vendim moskompentence nga subjekti i rivlerësimit.

Me qëllim vërtetimin e fakteve për të cilat janë ngritur dyshime, pas verifikimeve të kryera nga Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se:

Bazuar në informacionet zyrtare, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, është regjistruar materiali i referuar nga Policia Gjyqësore pranë kësaj prokurorie, në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, me nr. ***, datë 18.7.2019, sipas të cilit: "...znj. *Doloreza Musabelliu, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, ka hetuar dhe shpallur moskompetencën e procedimit penal në ngarkim të shtetasit M. M., në detyrë ***, i dyshuar për *** në kundërshtim me ligjin. Gjatë hetimit të këtij procedimi penal dhe në çastin e shpalljes së moskompetencës, ka informacione për dekonspirim të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" nga zonja Doloreza Musabelliu, e cila ka shpallur moskompetencën dhe transferuar procedimin në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor ****".

Pasi është administruar dosja e këtij procedimi, u konstatua se me vendim të datës 23.7.2019 të prokurorit A. Sh., është vendosur mosfillimi i procedimit penal për materialin e numërtuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale me nr. ***, datë 18.7.2019, për arsye se:

Së pari: nuk rezultoi që znj. Doloreza Musabelliu të ketë shpallur moskompetencën e procedimit penal në ngarkim të shtetasit M. M.. Procedimi penal nr. ***, datë 20.11.2018, është proceduar me moskompetencë lëndore nga prokurori K. B., i cili e ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit ***.

Së dyti : nuk rezultoi që znj. Doloreza Musabelliu në cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, të ketë kryer ndonjë veprim në mospërmbushje të detyrës së saj si prokurore.

Pavarësisht vendimit për mosfillimin e procedimit penal si më sipër, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me konkluzionet e raportit të DSIK-së.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në parashtrimet e datës 18.11.2019, por dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka mbajtur qëndrim kundërshtues ndaj raportit të DSIK-së, duke pretenduar se ky raport është i gabuar dhe i nxjerrë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore dhe rrethanat faktike, pasi sipas saj, nuk ka kryer asnjë nga veprimet që i atribuohet nga DSIK-ja. Konkretisht:

i) Në lidhje me dyshimet për korrupsion pasiv, të cilat kanë lidhje me shpalljen e moskompetencës së hetimit të një çështjeje penale në ngarkim të shtetasit M. M., subjekti argumentoi si vijon:

*"- nisur nga fakti që informacionin e pretenduar, Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar për kompetencë lëndore dhe trajtim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, del qartë mungesa e elementëve të korrupsionit ndaj meje në informacionin e ***, pasi nëse do të kishim elementë të pretenduara të korrupsionit ndaj meje, çështja penale automatikisht, do të shkonte për kompetencë lëndore në Prokurorinë për Krime të Rënda, e cila konform nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, është prokuroria e vetme në Republikën e Shqipërisë që trajton çështje që lidhen me korrupsionin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë;*

*- referuar akteve që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ka administruar në kuadër të verifikimeve të kallëzimit penal nr. ***, datë 18.7.2019, për të cilin ka vendosur*

*mosfillimin e hetimeve, rezulton se elementi i korrupsionit i pretenduar nga pikëpamja formale në informacionin e ***, i është atribuuar një prokurori të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor ***, (S. H.), kurse mua më kanë atribuuar veprën penale të shpërdorimit të detyrës nëpërmjet dekonspirimit të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror;*

*- çështja penale nr. ***, e vitit 2018 në të cilën përfshihet shtetasi M. M., është nën hetim prej meje në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe unë nuk kam disponuar me asnjë vendim moskompetence lidhur me këto çështje apo me këtë shtetas;*

*- në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë, është marrë një vendim moskompetence i procedimit penal nr. ***, i vitit 2018, ndaj subjektit M. M., nga një prokuror tjetër i Prokurorisë për Krime të Rënda, z. K. B”.*

ii) Në lidhje me dekonspirimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, subjekti pretendon se, në çështjen penale nr. ***, të vitit 2018, e cila është çështje nën hetim prej saj, nuk ka administruar në asnjë rast asnjë lloj informacioni të klasifikuar “sekret shtetëror”, dhe si pasojë, nuk ka rrjedhojë logjike dekonspirimi i tij. Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka vënë në dispozicion :

- shkresë nr. *** prot/D. B., Xh. K., datë 18.11.2019, i Drejtuesit të Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, znj. Donika Prela;

- shkresë me datë 18.11.2019 e Kryesekretares së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë;

- shkresë me datë 15.11.2019 e zyrës së regjistrimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda,

nga përmbajtja e të cilave, rezulton se:

1) për vitin 2018–2019, në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, nuk ka shkuar asnjë informacion i klasifikuar “sekret shtetëror” për shtetasin M. M., ***, lidhur me aktivitetin e tij kriminal dhe fillimin e hetimeve ndaj tij;

2) prokurorja Doloreza Musabelliu, nuk është njohur me asnjë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror” për këtë shtetas;

3) procedimi penal nr. ***, datë 9.5.2018, është në fazën e hetimeve dhe znj. Doloreza Musabelliu, nuk ka disponuar më asnjë vendim për shpalljen e moskompetencës.

iii) Znj. Doloreza Musabelli, e pyetur gjatë seancës dëgjimore, nëse është takuar ndonjëherë me shtetasin M. M., deklaroi se nuk e ka takuar asnjëherë këtë shtetas, në asnjë rrethanë.

Vlerësimi i Komisionit

Nga analiza e të gjitha provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit paraqiti mjaftueshëm argumente dhe prova, për të kundërshtuar raportin e dytë të DSIK-së, në referim të fakteve si vijojnë:

Së pari: nuk u vërtetua që nga ana e subjektit, të jetë disponuar me vendim moskompetence lëndore në ngarkim të shtetasit M. M. Për procedimin penal nr. ***, datë 20.11.2018, është proceduar me moskompetence lëndore dhe dërgimin për kompetencë në Prokurorinë në Gjykatën e Shkallës së Parë ***, me vendim të prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë , z. K. B.⁵⁷.

⁵⁷ Shihni shkresën kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 24.9.2019, nga Prokuroria parë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, Prokurorisë...dhe vendimin për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve të datës 20.11.2018, të prokurorit K. B..

Së dyti: në kushtet kur nuk u vërtetua që znj. Doloreza Musabelliu të ketë marrë vendim moskompetence për shtetasin M. M., dyshimet në lidhje me : (i) përfshirjen e saj në veprimtari korruptive; si dhe (ii) dekonspirimin e informacionit sekret, gjatë procedimit me vendim moskompetence për këtë shtetas, nuk rezultuan të provuara.

Së treti: lidhur me dekonspirimin e informacionit “sekret shtetëror”, nuk u vërtetua që znj. Doloreza Musabelliu të jetë njohur me ndonjë informacion të klasifikuar “sekret shtetëror” për shtetasin M. M.. Gjithashtu, nuk u administrua asnjë provë, që të vërtetojë dekonspirimin e këtij informacioni apo çdo lloj informacioni tjetër që ka lidhje me hetimin e çështjes.

Së katërti: Informacionin e marrë prej organeve ligjzbatuese, Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar për kompetencë lëndore dhe trajtim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërkohë që, nëse do të kishte elementë të pretenduara të korrupsionit ndaj subjektit të rivlerësimit, çështja penale automatikisht, do t'i shkonte për kompetencë lëndore në Prokurorinë për Krime të Rënda, e cila sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, është prokuroria e vetme në Republikën e Shqipërisë që trajton çështje që lidhen me korrupsionin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë.

Së pesti: nuk rezultoi që znj. Doloreza Musabelliu të ketë kryer ndonjë veprim në mospërbushje të rregullt të detyrës së saj si prokurore, vërtetuar me vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal” të datës 23.7.2019 të prokurorit A. Sh., sipas të cilit është vendosur mosfillimi i procedimit penal për materialin e numërtuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale me nr. ***, datë 18.7.2019.

Veç sa më sipër, pasi u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar në rrugë ligjore emrin nga Doloresa në Doloreza dhe mbiemrin nga Musabelli në Musabelliu, iu kërkua informacion nga DSIK-ja, në lidhje me figurën e subjektit të rivlerësimit me këto gjeneralitete. Nga informacioni i vënë në dispozicion prej organeve ligjzbatuese, nuk ka pasur të dhëna për kontakte të papërshtatshme të subjektit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe asnjë informacion tjetër që cenon figurën e subjektit të rivlerësimit.

Bazuar në të gjitha faktet dhe provat e administruara, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se konstatimi i DSIK-së, në raportin e dytë dërguar Komisionit, nuk është i bazuar në prova, dhe si ti tillë nuk duhet të merret në konsideratë.

Në përfundim, pasi nuk u konstatua asnjë e dhënë tjetër apo informacione të marra nga cildo burim i ligjshëm, për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprimtari korruptive apo kontakte të saj me persona të përfshirë në krimin e organizuar, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, është e përshtatshme për vijimin e ushtrimit të detyrës.

II.3 RIVLERËSIMI PROFESIONAL

Në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Doloreza Musabelliu, bazuar në:

A. Raportin për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 19.4.2019, sipas të cilit subjekti është vlerësuar pozitivisht dhe janë evidentuar aftësitë profesionale, si vijojnë :

1. Për aftësitë profesionale

a. Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ajo përdor arsyetim të qartë dhe lidhë saktë normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret. Subjekti ka njohuri të plota rreth parashikimeve të normave të Kodit Penal dhe instituteve të së drejtës penale. Gjithashtu,

subjekti ka treguar nivel shumë të lartë të analizës së provave dhe normave të së drejtës në raport më çështjen konkrete.

b. Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej saj kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse, dhe tregon kujdes që konkluzionet e saj të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt, dhe bazës ligjore të përdorur përgjatë arsyetimeve.

2. Për aftësinë organizative

a. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjektit i janë caktuar gjatë periudhës së punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, gjithsej 293 procedime penale dhe materiale për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, ka treguar aftësi shumë të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me shpejtësi dhe pa dëmtuar cilësinë e vendimmarrjes.

b. Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti është vlerësuar shumë mirë si prokurore për vitet 2015 dhe 2016, ndërsa për vitin 2014 nuk ka vlerësim (gjatë këtij viti, subjekti ka qenë me lejen e lindjes).

c. Aftësia për të administruar dosjet

Subjekti ka administruar në mënyrë të shpejtë dhe efikase ngarkesën e punës që i është caktuar. Siç vihet re, dosja e cila ka pasur zgjatje afati hetimor ka qenë procedimi penal nr. 126/2014, ku është konstatuar një letërporosi dërguar autoriteteve të drejtësisë italiane, e cila ka kërkuar rreth 1 vit për kthimin e përgjigjes.

3. Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a. Etika në punë

Për etikën në punë subjekti është vlerësuar shumë mirë. Ndaj subjektit nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

b. Integriteti

Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti, për subjektin e rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të saj.

c. Paanësia

Nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar, apo të ketë pasur cenim të të drejtave të pjesëmarrësve në proces, dhe grupeve shoqërore të tjera.

4. Për aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a. Aftësia e komunikimit

Nuk rezultojnë të dhëna të caktuara që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

b. Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

c. Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokuroerja Doloreza Musabelliu, i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe është angazhuar edhe në veprimtari

akademike dhe të mësimdhënies në Shkollën e Magjistraturës Tiranë, si dhe ka qenë pjesëmarrëse në cilësinë e lektorit/trajnesit/prezantuesit në një sërë temash në fushën penale.

B. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme ku si të tilla janë konsideruar:

1. Tre vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43, të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja.

2. Gjashtë denoncime⁵⁸ nga publiku, nga të cilat vetëm dy prej tyre përmbushin kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, dhe si rrjedhim, u kryen verifikimet si vijojnë :

2.1 Në lidhje me denoncimin e shtetasit A. B.⁵⁹, i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, ka shkelur ligjin me vendimin e shpalljes së moskompetencës lëndore për procedimin penal nr. *** të vitit 2018, vetëm për disa vepra penale, nga nëntë të kallëzuara prej tij. Nga aktet e vëna në dispozicion prej denoncuesit, u konstatua se:

- Në datën 12.3.2018 shtetasi A. B. ka paraqitur kallëzim, dërguar për kompetencë lëndore në prokurorinë e Elbasanit, në të cilin referoheshin veprat penale: “shpërdorim të detyrës”; “korrupsion pasiv i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”; “pengim të ekzekutimit të vendimeve të gjykatës”; “ mosekzekutim pa shkaqe të përligjura të vendimit të gjykatës”; ”veprime që vijnë në kundërshtim me vendimin e gjykatës”; si dhe “kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal” (e dhënë kjo e përfituar nga përmbajtja e vendimit nr. **, datë 9.1.2019, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë).

- Duke vlerësuar se veprat penale të referuara si me sipër, janë në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Prokuroria e Rrethit Elbasan ia ka dërguar aktet kësaj prokurorie (e dhënë kjo e përfituar nga përmbajtja e vendimit nr. **, datë 15.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).

- Kallëzimi i shtetasit A. B. është regjistruar në muajin maj të vitit 2018 për veprat penale të pretenduara prej tij, dhe në tetor të vitit 2018 Prokuroria e Krimeve të Rënda (prokurore Doloreza Musabelliu), ka regjistruar procedimin penal për disa nga veprat penale të parashtruara në kallëzim (e dhënë kjo e përfituar nga përmbajtja e vendimit nr. **, datë 9.1.2019 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë). Konkretisht, në datën 15.10.2018, subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore të çështjes penale nr. 184/2018 për veprat penale të “mashttrimit”, “mosekzekutim pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës” dhe “shpërdorimi i detyrës”, bazuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Vendimorja lidhur me këto tre vepra penale është në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

- Më tej, kallëzuesi e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me pretendimin se për veprat e tjera të kallëzuara prej tij subjekti i rivlerësimit nuk ishte shprehur. Kjo gjykatë ka vendosur mospranimin e ankimit.

- Në vijim, kallëzuesi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit për Krimeve të Rënda Tiranë, e cila ka vendosur sërish mospranimin e ankimit me vendimin nr. **, datë 9.1.2019. Referuar këtij vendimi, nga kjo gjykatë është vlerësuar se: “*Nga përmbajtja e vendimit për shpalljen e moskompetencës lëndore, evidentohet se janë kryer veprime verifikuese në lidhje me akuzat e*

⁵⁸ Shihni denoncim nga shtetasi V. C., protokolluar nga Komisioni me nr. ** prot., datë 2.2.2018; denoncim nga V. C. i përcjellë nga KPA-ja, protokolluar nga Komisioni me nr. ** prot., datë 11.7.2019; denoncim nga V. C. i përcjellë nga KPA-ja protokolluar nga Komisioni me nr. ** prot., datë 19.8.2019, në dosjen e Komisionit; kërkesë ankimore nga A. H., protokolluar nga Komisioni me nr. ** prot., datë 23.1.2019, në dosjen e Komisionit

⁵⁹ Shihni kallëzimin e datës 4.1.2019 nga A. B., bashkëlidhur shkresës nr. ** prot., datë 11.2.2019 të Komisionerit Publikë, si dhe aktet bashkëlidhur denoncimit të shtetasit A. B., depozituar në datën 11.10.2019, arkivuar me numrin e protokollit **.

lartpërmendura. Fakti që prokurori i çështjes thekson se “nuk ka asnjë indice për kryerje të akteve korruptive” është një argument që mbështet konkluzionin se, nuk ka asnjë shkak që të justifikojë fillimin e procedimit penal në lidhje me këto akuza. Por pavarësisht këtyre konstatimeve, rezulton se prokurori i çështjes nuk ka disponuar me vendim sipas parashikimeve ligjore...”

Në përfundim, Kolegji i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda çmon se konkluzioni i arritur nga prokurori “që nuk ka indice për kryerjen e veprave të tjera penale” duhet të ishte materializuar me një vendimmarrje konkrete. Për këtë arsye, kjo gjykatë ka vendosur urdhërimin e prokurorisë së krimeve të rënda të regjistrojë në regjistrin e njoftimit të veprave penale, procedimin penal në lidhje me veprat penale “korrupsioni pasiv i gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” dhe ‘korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendore”.

Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me denoncimin e kallëzuesit A. B., u konstatua se subjekti është shprehur me vendim moskompetence për tre vepra të kallëzuara prej tij, por, nuk është shprehur me një vendim të materializuar për mosfillimin ose pushimin e çështjeve penale të tjera kallëzuara prej tij, sipas parashikimit të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale. Me njoftimin e rezultateve të hetimit lidhur me këtë konstatim subjektit iu kërkuan sqarime.

Në parashtrimet e datës 18.11.2019, dhe në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se: “... listimi i një apo disa veprave penale nga kallëzuesi, nuk passjell detyrimin e prokurorit që të shprehet për secilën prej tyre, kur vlerëson se të gjitha referencat ligjore të kallëzuesit, përmbliohen në elementë të një ose më shumë figurash veprash penale. Sipas saj, pasi prokurori pasi bën kualifikimin e duhur ligjor në mënyrë të arsyetuar, logjike dhe ligjore, fatin e procedimit penal e vendos si për një të tërë, pa qenë i nevojshëm që ai të shprehet për secilën nga veprat e pretenduara nga kallëzimi me një vendim formal mosfillimi”.

Më tej ajo sqaron se : “... qëndrimi i unifikuar i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka qene se nuk procedohet brenda të një njëjtit procedim me regjistrim procedimi për një numër veprash penale dhe me mosfillim për një numër veprash penale te tjera. ... në vendimin e regjistrimit, arsyetohet mungesa e elementëve të veprës penale për veprat për të cilat konkludohet se nuk ekzistojnë dhe të cilat nuk duhen regjistruar në procedimin penal”.

Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë, subjekti ka deklaruar se nuk e komenton, përveç se vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka dalë jashtë objektit të gjykimit të saj, duke vendosur regjistrimin e procedimit penal për veprat që sipas gjykatës, prokurori nuk është shprehur me vendim mosfillimi. Gjithashtu, subjekti paraqiti një praktikë të prokurorisë së Durrësit, sipas të cilës, bëhet fjalë për një rast tjetër, ku Policia Gjyqësore ka referuar për disa vepra penale, ndërsa prokurorja e çështjes ka regjistruar vetëm veprat penale që ajo ka çmuar.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit profesional, duke i konsideruar bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me denoncimin e denoncuesit A. B., si dhe referuar fakteve: (i) si Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ashtu dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, kanë vendosur mospranimin e ankimit të denoncuesit A. B.; (ii) vendimmarrja e subjektit për veprat e kallëzuara prej këtij shtetasi është cenuar nga Kolegji i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, vetëm në pikëpamjen formale dhe jo atë materiale, nga ana e Komisionit, nuk u konstatuan veprime/mosveprime të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të vendimmarrjes, që të kenë sjellë si pasojë cenimin e aftësive të saj profesionale.

2.2 Në lidhje me denoncimin e shtetasit S. P.⁶⁰ u konstatua se ky shtetas ngre pretendime për korrupsion, në lidhje me prokurorin A. D.. Sipas tij, ky prokuror ka qenë nën hetim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe çështjen e ka pasur prokurorja Doloreza Musabelliu në vitin 2018, hetime të cilat sipas tij janë ndërprerë, por nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë bashkangjitur, me qëllim vërtetimin e këtij pretendimi.

Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me këtë denoncim: (i) nga verifikimi pranë organeve ligjzbatuese nuk rezultoi të ketë pasur informacione; (ii) nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Prokuroria e Krimeve të Rënda⁶¹, nuk rezultoi që emri i shtetasit A. D., të jetë regjistruar në regjistër, si person të cilit i atribuohet vepra penale, regjistrim i cili kryhet nga prokurori, kur krijohet bindje për përfshirjen e subjekteve në vepra penale. Gjithashtu, prej një informacioni konfidencial, të administruar gjatë hetimit administrativ, rezultoi se, për rastin në fjalë, nuk ka ndërprerje hetimesh nga subjekti i rivlerësimit.

3. Informacioni i marrë nga të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime:

Sipas këtij informacioni, ka rezultuar një ankesë në adresë të subjektit të rivlerësimit në vitin 2018, nga shtetasi K. T.. Ky shtetas ka pretenduar se znj. Doloreza Musabelliu, e cila ka qenë prokurore në hetimin e kryer ndaj të birit të tij i akuzuar për trafikim të miturish, si dhe për prodhim dhe shitje lëndësh narkotike, ka ngritur akuza të padrejta ndaj djalit të tij, si dhe ka frikësuar dëshmitarët gjatë pyetjes së tyre, duke i kërcënuar haptazi në gjyq.

Pas verifikimeve të kryera gjatë hetimit administrativ⁶² nuk rezultuan veprime të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe as sjellje jo etike të saj, gjatë procesit të marrjes në pyetje të dëshmitarëve.

C. Rivlerësimi profesional sipas kritereve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kritereve të parashikuara në kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit ka treguar të mira profesionale, sipas nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74, të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76, të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75, i ligjit nr. 96/2016.

Në përfundim, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, pas propozimit të relatores së çështjes, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, si dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme në punë, dhe si rrjedhim ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale.

⁶⁰ Shihni letër “për aferat korruptive të prokurorit A. D.”, në dosjen e Komisionit.

⁶¹ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. ***, D. B., D. M., datë 3.5.2019 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁶² Shihni dokumentacionin bashkëlidhur shkresës “dërgim aktesh” nr. *** prot., datë 12.07.2019, nga Gjykata e Lartë, dhe CD audio bashkëlidhur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 31.7.2019, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, në dosjen e Komisionit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar: (i) me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46, të ligjit nr. 84/2016; si dhe (ii) në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë seancës dëgjimore, ku subjekti ishte prezent, pa praninë e ndonjë përfaqësuesi ligjor.

Në të gjitha komunikimet, znj. Doloreza Musabelliu ka qenë e gatshme, duke u treguar tërësisht bashkëpunuese, pasi i është përgjigjur me korrektesë brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë në mënyrë shteruese informacionin e kërkuar, gjë që është mbajtur në konsideratë në marrjen e vendimit, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016.

IV. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 2.12.2019, u zhvillua seanca dëgjimore sipas nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, në përfundim të së cilës, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues i Komisionit, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me pasurinë, me figurën dhe me aftësitë profesionale, vlerësoi se procesi i vendimmarrjes në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, duhet të bazohet në vlerësimin tërësor të të tria kriterëve, referuar pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioni, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi subjektin, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, dhe shpall këtë vendim, në datën 5.12.2019, sipas pikës 6, nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Përpos konstatimeve të rezultuara në përfundim të procesit të rivlerësimit për të tria kriteret si më sipër, gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni është bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të rrethanave për të tria kriteret, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, referuar edhe fakteve si vijojnë:

- Gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, deklaratimet e znj. Doloreza Musabelliu, kanë qenë në lidhje me të ardhura të saj të përfituara nga paga apo nga kredi konsumatore. Objekt i deklaratimeve të saj nuk kanë qenë në asnjë rast pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, si dhe të drejta reale të pronësisë të ushtruara prej saj, të rrjedhura nga marrëdhënie juridike të cilitdo lloji të parashikuara nga Kodi Civil, përveç depozitave bankare. Nuk u vërtetua, asnjë fakt dhe rrethanë që të vijë në kundërshtim apo të vërtetojë pasuri të tjera në emër të subjektit, krahasuar me deklaratat e saj ndër vite, apo me deklaratën “Vetting”.
- Nuk u administrua asnjë e dhënë nga cilido burim i ligjshëm për pasuri të tjera të shtetasit G. D., si dhe nuk u vërtetua asnjë fakt dhe rrethanë që të vijë në kundërshtim me deklaratat e tij ndër vite, apo me deklaratën “Vetting”.
- Bashkëjetuesi i subjektit, z. G. D., ka deklaruar një apartament dhe një autoveturë, krijuar përkatësisht në vitet 2006 (vit në të cilin ka filluar bashkëjetesa) dhe 2009, me të cilat në asnjë rast nuk u evidentuan lidhje të drejtpërdrejta ose jo të subjektit të rivlerësimit.
- Nuk u vërtetua asnjë kontribut i subjektit për blerjen e të dyja pasurive në pronësi të plotë të bashkëjetuesit, z. G. D., të cilat u vërtetua të jenë blerë me të ardhura nga aktiviteti privat i babait të tij, shtetasit K. D., në periudhën nga 1999 – 2009.

- Pas vitit 2009, u vërtetua që shtetasi K. D. ka ndërprerë aktivitetin privat. Pas këtij viti, as subjekti dhe as bashkëjetuesi i saj nuk kanë blerë pasuri të tjera, si dhe nuk u konstatua të kenë të ardhura të tjera veç atyre nga pagat (për subjektin e rivlerësimit), dhe nga aktiviteti si noter (për bashkëjetuesin e saj).
- Kodi i Familjes në nenin 74 të tij, parashikon që vetëm pasuritë e fituara gjatë martesës ligjore, i nënshtrohen regjimit pasuror të bashkëshorteve, si rrjedhim pasuritë e vëna veç e veç nga dy bashkëjetues, janë 100 % në pronësi të tyre. Pavarësisht këtij fakti, si ligji nr. 84/2016, ashtu dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në Aneksin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, kanë parashikuar detyrimin e subjekteve të rivlerësimit që të deklarojnë pasuri e interesa private edhe të bashkëjetuesit. Ky parashikim ligjor është bërë, pikërisht, me qëllim që nëpërmjet deklarimeve periodike dhe nëpërmjet procesit të rivlerësimit, të konstatohen ndikime të paligjshme të subjekteve të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksioneve të tyre, në krijimin e pasurive në emër të bashkëjetuesave apo në bashkëpronësi të tyre, duke evidentuar fshehjen e çdo lloji pasurie, deklarime të rremë, si dhe likuiditete të pajustificuara me të ardhura të ligjshme, të cilat në rastin e subjektit të rivlerësimit nuk u konstatuan.
- Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike qoftë nga subjekti, qoftë nga bashkëjetuesi i saj, si dhe balanca negative prej 289.482 lekësh gjatë vitit 2016, vlerësuar me objektivitet dhe në proporcion me të gjitha faktet e rrethanat e evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohen si deklaratime të pamjaftueshme, të cilat të kenë sjellë pasojë të parashikuara nga neni 33, i ligjit nr. 4/2016, apo të kenë cenuar besimin e publikut të subjektit të rivlerësimit, si pjesë e sistemit të drejtësisë.

V. KONKLuzion Përfundimtar

1. Referuar nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
2. Referuar nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
3. Referuar nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi kreu bisedimet për marrjen e vendimit në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Doloreza Musabelliu, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelistit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 05.12.2019.

ANTËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES

Alma FASKAJ

RELATOR

Firdes SHULI

ANËTAR

Pamela QIRKO

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka